



DEMAND FOR JUSTICE
KËRKO DREJTËSI
TRAŽI PRAVDU



RAPORTI I ANKETËS “INICIATIVA PËR INTEGRITET NË SISTEMIN E DREJTËSISË

NËNTOR - 2017

 KOSOVA
DEMOCRATIC
INSTITUTE

 TRANSPARENCY
INTERNATIONAL
KOSOVA



DEMAND FOR JUSTICE
KËRKO DREJTËSI
TRAŽI PRAVDU



RAPORTI I ANKETËS “INICIATIVA PËR INTEGRITET NË SISTEMIN E DREJTËSISË

NËNTOR - 2017

Programi Kërko Drejtësi (D4J) financohet nga Departamenti i Shtetit Amerikan/INL dhe implementohet nga Qendra Kombëtare për Gjykata Shtetërore (NCSC) për të mbështetur zhvillimin e fuqishëm të kërkesës për drejtësi në Kosovë të bazuar në dëshmi. Njëpërmjet D4J, NCSC është duke i mobilizuar OSHC-të partnere për të vepruar si agjentë të ndryshimit për të nxitur llogaridhënie, transparencë dhe integritet në sektorin e drejtësisë.

Ky/kjo raport është bërë i/e mundur me mbështetje të Departamentit të Shtetit Amerikan përmes Programit Kërko Drejtësi. Opinionet, gjetjet dhe konkluzionet apo rekomandimet e shprehura këtu janë ato të autorit (ëve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Departamentit të Shtetit Amerikan apo Qendrës Kombëtare për Gjykata Shtetërore.

Autor: **Arben Kelmendi**
Layout & Design: **Envinion**

COPYRIGHT © 2017. Kosova Democratic Institute (KDI).

Kosova Democratic Institute reserves all rights to this report and no part of this publication is subject to reproduction or retransmission in any mechanical or electronic form, including photocopying or storing in retrieval system of materials without the publisher's prior authorisation in writing. This publication can be reproduced or transmitted only for non-commercial purposes. Whosoever intends to use excerpts or documents from this publication is obliged to clearly attribute the source wherever and whenever the excerpts or materials are reproduced.

Should you have any comments, criticism or suggestions, you are kindly requested to contact the publisher through any of the following means:

Address: Str. Bajram Kelmendi, No. 45,
10 000, Prishtina, Kosovo.
Tel.: +381 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Web: www.kdi-kosova.org

PARATHËNIE.....	8
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	9
KONTEKSTI I STUDIMIT.....	10
VEPRIMET KORRUPTIVE SIPAS KODIT PENAL TË KOSOVËS	10
METODOLOGJIA	13
PLANI PËR PËRZGJEDHJEN E MOSTRËS	14
TESTIMI DHE VALIDIMI I INSTRUMENTIT TË ANKETËS.....	16
ANKETIMI.....	16
KUFIZIMET DHE PENGESAT.....	18
AKTIVITETET PËRCJELLËSE KËRKIMORE	18
SHPREHJET DHE PËRKUFIZIMET E PËRDORURA GJATË ANKETËS.....	18
TË GJETURAT KËRKIMORE DHE ANALIZA	20
1. NIVELI I KORRUPSIONIT TË PERCEPTUAR.....	22
2. FORMAT E KORRUPSIONIT	25
3. NDËRMJETËSIT E SJELLJES SË KORRUPTUAR	28
4. NDËRVEPRIMET NDËRMJET PROFESIONEVE TË NDRYSHME.....	30
5. REZULTATET E SYNUARA	31
6. GRUPET E PRIRURA PËR KORRUPSION.....	32
7. NXITËSIT E SJELLJEVE KORRUPTIVE.....	33
8. FAZAT E PROCESIT GJYQËSOR	33
9. RREZIQET E KORRUPSIONIT	35

TABELA E PË

KONKLuzionet	36
REKOMANDIMET	37
BIBLIOGRAFIA	39
SHTOJCA 1: LITERATURA E SHQYRTUAR	40
SHTOJCA 2: SISTEMI I DREJTËSISË NË KOSOVË.....	43
GJYKATAT E KOSOVËS	43
PROKURORI SHTETËROR	43
ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS	43
POLICIA E KOSOVËS	44
SHTOJCA 3: MEKANIZMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM.....	45
KOMISIONI DISIPLINOR I KGJK-SË.....	45
KOMISIONI DISIPLINOR I KPK-SË	45
ZYRA E PROKURORIT DISIPLINOR	45
ZYRA DISIPLINORE NË OAK	46
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS.....	46

ERMBAJTJES



PARATHËNIE

Jemi shumë mirënjohës për mundësinë për të prezantuar Iniciativën për Integritet në Sistemin e Drejtësisë (IISD) në Kosovë. Kjo iniciativë u zhvilluar nga Shoqata Ndërkombëtare e Avokatëve (IBA – International Bar Association) si përpjekje shtesë e Shoqatës për të luftuar korrupsionin në nivel global. Me rastin e lansimit të anketës në vitin 2015, David W Rivkin, ish-presidenti i IBA, deklaroi se "qëllimi i Iniciativës për Integritet në Sistemin e Drejtësisë është të rrisë ndërgjegjësimin për pasojat ligjore të korrupsionit në drejtësi aty ku ekziston, ta luftojë atë përmes promovimit të standardeve më të larta të integritetit mes gjyqtarëve, prokurorëve, personelit gjyqësor dhe avokatëve dhe të inkurajojë praktikatat më të mira të shteteve që kanë punuar në mënyrë efektive në eliminimin e korrupsionit. Është e qartë se kemi shumë punë për të bërë."

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) është plotësisht i vetëdijshëm për rolin kyç të sistemit të drejtësisë në luftën kundër korrupsionit, prandaj është e domosdoshme që ky sistem të ruajë pavarësinë dhe paanshmërinë e tij. Shfaqja e sjelljeve korruptive në sistemin e drejtësisë dëmton sundimin e ligjit dhe shkakton humbjen e besimit të qytetarëve tek institucionet publike dhe aftësisë së tyre për të ofruar shërbime. Në anën tjetër, niveli i lartë i korrupsionit gjyqësor në një vend pamundëson luftimin e kësaj dukurie negative në degët tjera të sistemit qeverisës të atij vendi.

KDI-ja i falënderon krerët e institucioneve kyçe të sistemit të drejtësisë në Kosovë (Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës, Odën e Avokatëve të Kosovës, Policinë e Kosovës dhe Inspektoratin Policor të Kosovës) për mbështetjen e tyre të vazhdueshme gjatë gjithë projektit. KDI i është gjithashtu falënderues Qendrës Kombëtare të Gjykatave Shtetërore (NCSC – National Centre of State Courts) për besimin e tyre në kapacitetet e KDI-së për të realizuar një anketë të paanshme dhe objektive me akterët e drejtësisë në Kosovë.

Ismet Kryeziu,

Drejtor Ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës



PËRMBLEDHJE

Ky raport është rezultat i punës së përbashkët të Instituti Demokratik të Kosovës (KDI) dhe Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK) dhe paraqet rastin e parë të adoptimit të Inicativës për Integritet në Sistemin e Drejtësisë (IISD) në kontekstin lokal me një mostër përfaqësuese të popullsisë. Anketa synon të ndihmojë udhëheqësit në Sistemit e Drejtësisë në Kosovë në identifikimin e modeleve të praktikave korruptive gjatë ndërveprimit ndërmjet akterëve të sistemit të drejtësisë dhe të promovoj standarde më të larta të integritetit mes gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve, policisë si dhe personelit përkatës gjyqësor dhe prokurorial. Kjo anketë fillimisht ishte hartuar dhe zbatuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Avokatëve (IBA) si pjesë e Inicativës për Integritet në Sistemin e Drejtësisë (IISD). Kjo iniciativë u ofroi akterëve të sistemit të drejtësisë një mundësi unike për të ndarë në mënyrë plotësisht anonime shqetësimet e tyre mbi mekanizmat e sjelljeve korruptive dhe rrethanat aktuale brenda sistemit që paraqesin "barriera ndaj integritetit të tyre". Pyetjet e paraqitura gjatë anketës synonin të kuptonin:

- 1 Modelet më të përhapura të sjelljeve korruptive brenda sistemit të drejtësisë
- 2 Rreziqet e korrupsionit gjatë ndërveprimeve mes akterëve në sistemin e drejtësisë dhe
- 3 Rreziqet që dalin gjatë fazave të ndryshme të procesit gjyqësor.

Për shkak se pyetësi ishte dizajnuar për shpërndarje globale, konceptet dhe kategoritë e përfshira duhej të përshtateshin sipas kontekstit specifik të Kosovës.

Qytetarët kosovarë vazhdojnë të perceptojnë institucionet e sistemit të drejtësisë si institucionet më së paku të besuara. Instituti Demokratik i Kosovës në "Vlerësimin e Sistemit Kombëtar të Integritetit në Kosovë" (Tetor 2015) deklaroi se institucioneve të sistemit të drejtësisë (gjyqësorit, prokurorisë dhe policisë) iu mungon integriteti institucional, ndershmëria dhe parimet tjera morale për t'i shërbyer interesit publik. KDI përshkruan më tej se si këto institucione janë të prira ndaj ndikimit politik që mund të shpjegoj mungesën e dënimeve për akuza të korrupsionit të politikanëve të lartë. Në mënyrë të ngjashme, në nivel global, Shoqata Ndërkombëtare e Avokatëve thekson se si "ushtrohet ndikim i panevojshëm politik mbi gjyqësorin për të garantuar mos-ndëshkimin e anëtarëve të elitave politike

dhe ekonomike" ("Sistemi i Drejtësisë dhe Korrupsioni", maj 2016). Kohëve të fundit, në gusht të vitit 2017, Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS – Group for Legal and Political Studies) botoi raportin me titull "Indeksi i Performancës së Institucioneve të Sundimit të Ligjit në Kosovë". Sipas raportit, perceptimi publik mbi nivelin e ndikimit politik në institucione të ndryshme tregon se më së shumti të ndikuar nga politika janë gjykatat (77.4 përqind), prokuroria (67.9 përqind), policia (41.7 përqind) dhe Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX (17.6 përqind).

Qëllimi i këtij raporti të tipologjisë është paraqitja e rezultateve të këtij anketimi shumëdimensional. I gjithë projekti është përshkruar nga aktivitete të shumta para anketës, mbajtjes së fokus grupeve (pas përfundimit të anketimit) dhe intervistave individuale me akterët kyç të sektorit të drejtësisë në Kosovë. KDI pranon se ka përpjekje brenda sistemit të drejtësisë në Kosovo në luftën kundër korrupsionit dhe inkurajon pavarësinë dhe paanshmërinë në vendimmarrje gjyqësore. Po ashtu inkurajon Oden e Avokatëve të Kosovës, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Policinë e Kosovës për të zhvilluar masat e duhura për të adresuar të gjeturat e këtij raporti. KDI dhe organizatat tjera të shoqërisë civile janë të gatshme të marrin pjesë në diskutime të tilla dhe të japin kontribut të vlefshëm në gjetjen e zgjidhjeve për problemet me integritetin në sistemin e drejtësisë.

Lansimi i këtij raporti shënon përfundimin e fazës së parë të Inicativës për Integritetin në Sistemin e Drejtësisë. Iniciativa do të fokusohet në dizajnimin e veprimeve praktike që mund të kenë ndikim në reduktimin e sjelljeve korruptive në sistemin e drejtësisë. Këto veprime do të mund të përfshinin:

- a **Përmbledhjen e praktikave më të mira në botë** adresimin e mangësive në integritetin në Drejtësi;
- b Ndërtimin e një **sistemi të certifikimit** si dëshmi e ekzistimit të procedurave për parandalimin të sjelljeve korruptive brenda institucioneve;
- c Arritjen e një marrëveshje kompakte që do të njihet si **"Deklarata kundër korrupsionit"** e do të nënshkruhet nga profesionistët në sistemin e drejtësisë;
- d **Studimin e kodeve aktuale të etikës**, me theks të veçantë dispozitat e ndërlidhura me sjelljet korruptive në Sistemin e Drejtësisë;

KONTEKSTI I STUDIMIT

Korrupsioni vazhdon të lulëzojë në Kosovë - vendi që raportohet të ketë shkallën më të lartë të varfërisë dhe papunësisë në Evropë¹. Pas gati një dekade të pavarësisë, shumica e përpjekjeve të qeverisë për të adresuar problemin e korrupsionit kanë përfunduar me përpilimin e strategjive kombëtare anti-korrupsion dhe planeve të veprimit të cilat vazhdojnë të jenë më tepër lista të dëshirave sesa zgjidhje praktike². Kohë pas kohe, këto strategji diskutohen në vazhden e veprimeve të qeverisë, por rezultatet mbeten sipërfaqësore.

Derisa sistemi i drejtësisë i Kosovës duhet të jetë në ballë të betejës kundër korrupsionit, rastet e rralla të ndjekjes së suksesshme të rasteve të korrupsionit tregojnë se akterët e sistemit të drejtësisë nuk janë të pavarur dhe të aftë për ushtrimin e kompetencave të tyre për të luftuar korrupsionin. Raporti i fundit i UNDP-së "Pulsi Publik" (nëntor 2016) mbi perceptimin e qytetarëve për korrupsionin në shkallë të gjerë jo vetëm që tregon përhapjen e tij në institucionet qendrore, por gjithashtu tregon rritje të konsiderueshme gjatë gjashtë muajve të fundit (36.5%, krahasuar me 27.5% në prill 2016). Tre institucionet më të korruptuara, sipas perceptimit të publikut, janë: ofruesit e kujdesit shëndetësor (50% krahasuar me 38% në prill 2016), gjykatat e Kosovës (49% në krahasim me 42% në prill 2016) dhe administrata/ institucionet qendrore (49% krahasuar me 37% në prill 2016 (UNDP, Pulsi Publik XII, nëntor 2016).

Ekzekutivi dhe legjislativi i qeverisë ushtrojnë ndikim të theksuar mbi gjyqësorin. Një shembull që vë në dyshim autonominë e gjyqësorit është procesi i planifikimit të buxhetit për institucionet gjyqësore dhe prokuroriale. Si rrjedhojë, numri i gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit mbështetës është larg të qenit i mjaftueshëm dhe vetëm një numër i vogël prej tyre kanë aftësitë e nevojshme për të ngritë padi kundër kriminelëve të dyshuar.³

Veprimet korruptive sipas Kodit Penal të Kosovës

Kjo pjesë e raportit ofron një pasqyrë të përgjithshme të kornizës aktuale ligjore të Kosovës që përcakton rregullat dhe ndërton mekanizmat për luftimin e korrupsionit zyrtar dhe veprat penale ndaj detyrës zyrtare. Kodi Penal i Republikës së Kosovës në kapitullin e tij XXXIV ("Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare") përcakton që "Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t'i shkel të drejtat e personit tjetër, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet. Më poshtë janë paraqitur llojet e korrupsionit në Kodin Penal të Republikës së Kosovës"⁴:

- **Keqpërdorimi i informatave zyrtare** ndodh kur një person zyrtar keqpërdor informacionin zyrtar⁵ me qëllim të përfitoj ndonjë përparësi që nuk i takon për vete ose për një person tjetër⁶.
- **Konflikti i interesit** ndodh kur personi zyrtar merr pjesë⁷ personalisht në ndonjë çështje zyrtare⁸ në të cilën ai ose ajo, një anëtar i familjes së tij/saj ose ndonjë person juridik i ndërlidhur⁹ ka një interes personal ose financiar.¹⁰

4 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kapitulli XXXIV, Neni 422, Paragrafi 1

5 Informacioni zyrtar është çdo informacion në të cilin një person zyrtar ka qasje përmes pozitës/zyrës ose punësimit të tij dhe që nuk është bërë publike.

6 Kodi Nr. 04/L-082 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kapitulli XXXIV, Neni 423, Paragrafi 1, në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocument-Detail.aspx?ActID=2834>.

7 Pjesëmarrja përcaktohet si ushtrimi i autoritetit zyrtar nëpërmjet vendimit, aprovimit, mosmiratimit, rekomandimit, dhënies së këshillave, hetimit ose ushtrimit në ndonjë mënyrë tjetër të ndikimit mbi ndonjë çështje zyrtare.

8 Çështja zyrtare përfshin procedurat gjyqësore ose tjera zyrtare; një aplikacion, kërkesë për një vendim ose një përcaktim tjetër zyrtar; një kontratë ose kërkesë; ankand publik ose veprime tjera të prokurimit; ose, një çështje tjetër që ndikon në interesat financiare ose personale të zyrtarit ose të ndonjë personi tjetër

9 Personi i ndërlidhur juridik nënkupton çdo person juridik në të cilin zyrtari ose një anëtar i familjes ka një marrëdhënie financiare, duke përfshirë një marrëdhënie ose një marrëdhënie të ardhshme si person përgjegjës ose punonjës

10 Kodi Nr. 04/L-082 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kapitulli XXXIV, Neni 424, Paragrafi 1, në dispozicion në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocument-Detail.aspx?ActID=2834>.

1 Instituti Demokratik i Kosovës, Raporti i Vlerësimit të Sistemit të Integritetit Kombëtar në Kosovë, tetor 2015, faqe 18

2 Po aty, faqe 18

3 Po aty, faqe 18



- **Shpërdorimi në detyrë** ndodh kur personi zyrtar synon të përfitoj një dobi materiale të paligjshme për veten ose ndonjë person tjetër, përvetëson pronën që i është besuar atij/asaj për shkak të detyrës ose pozitës së tij/saj¹¹.
- **Mashtrimi në detyrë** ndodh kur personi zyrtar, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, bën prezantimin e rremë të raportit të llogarive apo në ndonjë mënyrë tjetër e vë në lajthim personin e autorizuar në kryerjen e pagesës së kundërligjshme¹².
- **Përdorimi i paautorizuar i pasurisë** ndodh kur personi zyrtar, pa autorizim përdor paratë, letrat me vlerë apo pasurinë tjetër të luajtshme e cila i është besuar atij/asaj¹³.
- **Marrja e ryshfetit** ndodh kur personi zyrtar, kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër, ose që pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë, në mënyrë që personi zyrtar të veprojë ose të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare¹⁴.
- **Dhënia e ryshfetit** mund të iniciohet nga kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, i premtton, ofron ose i jep ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër personit zyrtar, në mënyrë që ai person të veprojë ose të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij/saj zyrtare¹⁵.
- **Ushtrimi i ndikimit** ndodh atëherë kur kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër, ose pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë, në mënyrë që të ushtrojë ndikim të padrejtë mbi vendimmarrjen e personit zyrtar apo zyrtarit publik të huaj, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose pavarësisht nëse ndikimi i supozuar shpie deri te rezultati i synuar¹⁶.
- **Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore** ndodh kur gjyqtari i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër ose për t'i shkaktuar dëm personit tjetër, nxjerr vendim të kundërligjshëm¹⁷.

11 Po aty, Neni 425, Paragrafi 1

12 Po aty, Neni 426, Paragrafi 1

13 Po aty, Neni 427, Paragrafi 1

14 Po aty, Neni 428, Paragrafi 1

15 Po aty, Neni 429, Paragrafi 1

16 Po aty, Neni 431, Paragrafi 1

17 Po aty, Neni 432, Paragrafi 1





Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare ndodh kur një person, i cili sipas ligjit është i detyruar të bëjë deklarimin e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, dhe i cili nuk bën një gjë të tillë.

- **Zbulimi i fshehtësisë zyrtare**¹⁸ ndodh kur personi zyrtar i cili pa autorizim kumton, dërgon ose në ndonjë mënyrë tjetër i vë në dispozicion personit tjetër informatën që përbën fshehtësi zyrtare¹⁹.
- **Falsifikimi i dokumentit zyrtar** ndodh kur personi zyrtar i cili në dokumentin zyrtar, në regjistër ose në shkresën zyrtare shënon të dhëna të rreme ose nuk shënon të dhënat e duhura apo me nënshkrimin e tij ose me vulën zyrtare vërteton dokumentin zyrtar, regjistrin apo shkresën zyrtare e cila përmban të dhëna të rreme ose mundëson përpilimin e dokumentit të tillë²⁰.
- **Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme** konsiderohet secili rast kur një person zyrtar i cili arkëton nga tjetri diçka që personi i tillë nuk është i detyruar të paguajë ose arkëton më shumë se që personi i tillë është i detyruar të paguajë apo që gjatë pagesës ose dërgesës, paguan ose dërgon më pak se që është dashur.²¹
- **Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor** ndodh kur personi zyrtar i cili gjatë bastisjes së lokaleve, personit apo gjatë ekzekutimit të vendimit gjyqësor, merr pasurinë e luajtshme me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete ose për personin tjetër.²²
- **Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare** ndodh kur një person, i cili sipas ligjit është i detyruar të bëjë deklarimin e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, dhe i cili nuk bën një gjë të tillë.²³

18 Sekret i zyrtar përkufizohet si informacion ose dokument i shpallur me ligj, dispozita tjera ose me vendim të autoritetit kompetent të nxjerrë në bazë të ligjit, si sekret zyrtar dhe zbulimi i të cilave ka shkakuar ose mund të shkaktojë pasoja të dëmshme.

19 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kapitulli XXXIV, Neni 433, Paragrafi 1

20 Po aty, Neni 434, Paragrafi 1

21 Po aty, Neni 435, Paragrafi 1

22 Po aty, Neni 436, Paragrafi 1

23 Po aty, Neni 437, Paragrafi 1



METODOLOGJIA

Kur u zhvillua për here të parë në nivel global më 2015, anketa “Iniciativa për Integritet në Sistemin e Drejtësisë” nuk ishte dizajnuar që të respektoj në mënyrë rigorozë kriteret shkencore për realizimin e anketave. Në atë kohë, vlerësohej se më e rëndësishme ishte të iniciohej një diskutim gjithëpërfshirës mes akterëve të sistemit të drejtësisë nga shtetet me tradita të ndryshme juridike. Si rrjedhojë, metodologjia joformale e IBA-së varej nga pjesëmarrja vullnetare e një përqindjeje modeste të akterëve të sistemit të drejtësisë (gjykatës, prokurorë dhe avokatë) në vendet ku IBA kishte krijuar raporte të mira.²⁴

Për dallim nga anketa e zhvilluar nga IBA, hulumtimi i kryer në Kosovë filloi pasi u sigurua mbështetja dhe përkushtimi i udhëheqësve e institucioneve të sistemit të drejtësisë. Në këtë mënyrë, Instituti Demokratik i Kosovës dhe Oda e Avokatëve të Kosovës (OAK) mund të llogarisnin në pjesëmarrjen aktive dhe të sinqertë të të gjithë akterëve të sistemit të drejtësisë të zgjedhur në mënyrë të rastësishme. Që nga fillimi, Instituti Demokratik i Kosovës dhe Qendra Nacionale për Gjykatat Shtetërore (NCSC) ishin të vetëdijshme për nivelin e lartë të ndjeshmërisë së anketës rreth korrupsionit në Sistemin e Drejtësisë i cili kërkonte perspektivën e bazuar në përvojën e gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve, policisë dhe hetuesve disiplinorë. Kështu, projekti përdori një metodë të kombinuar hulumtimi që bazohet në të dhënat sasiore (kuantitative) dhe ato cilësore (kualitative).

²⁴ Anketa e IBA-së u krye në internet nga 2 tetori 2015 deri më 30 tetor 2015 dhe u promovua përmes anëtarëve individualë të IBA-së, rrjetit të saj të shoqatave kombëtare të avokatëve, komiteteve të saja, forume të gjykatësve dhe disa organizata partnere. Anketa u u ofrua në tetë gjuhë: angleze, frënge, kineze, ruse, arabe, japoneze, koreane dhe indoneziane. Janë pranuar gjithsej 1,577 përgjigje nga 120 vende. Përgjigjet e kufizuara të marra nga 89 vende të anketuara ishin shumë pak për të lejuar një analizë kuptimplotë dhe të besueshme dhe për këtë arsye dhe për të siguruar vlefshmërinë e rezultateve tona, IBA e kufizoi analizën në ato vende për të cilat morëm një minimum prej dhjetë përgjigjeve. Gjetjet e studimit që kemi raportuar në raportin e IBA burojnë nga gjithsej 1,204 respondentë nga 31 vende.

1 Dizajnimi i hulumtimit filloi në nëntor 2016 kur KDI dhe NCSC në Kosovë filluan të punojnë me Odën e Avokatëve të Kosovës dhe Shoqatën Ndërkombëtare të Avokatëve (IBA) me qëllim të ndërtimit të raporteve dhe besimit me udhëheqësit e institucioneve të sistemit të drejtësisë.

2 Shqyrtimi i literaturës ekzistuese i mundësoi KDI-së të njoftohej me dukurinë e sjelljeve korruptive në sistemin e drejtësisë si dhe grumbullimin e informatave rreth udhëzuesve, standardeve dhe parimeve ndërkombëtare. KDI gjithashtu shqyrtoi një numër raportesh lidhur me sfidat me të cilat ballafaqohet sistemi i drejtësisë në Kosovë.

3 Letrat e nënshkruara të bashkëpunimit nga krerët e institucioneve (Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Oda e Avokatëve të Kosovës, Policia e Kosovës dhe Inspektorati i Policisë së Kosovës) siguruan mbështetje institucionale për hulumtimin dhe shkallë të lartë të pjesëmarrjes nga të anketuarit.

4 Fokus grupet e zhvilluara para anketimit u përdorën për të testuar dhe verifikuar metodologjinë e përzgjedhur për të zhvilluar hulumtimin, në mënyrë të veçantë për t’u siguruar që të gjitha pyetjet në pyetësor janë të qarta dhe koncize.

5 Zhvillimi i hulumtimit në nivelin kombëtar me akterët kyç të sistemit të drejtësisë në Kosovë (gjykatësit, prokurorët, hetuesit policorë, inspektorati policor, personeli i gjykatave dhe prokurorive).

6 Aktivitetet pas hulumtimit (fokus grupet dhe intervistat individuale) të zhvilluar me akterë rajonale të sistemit të drejtësisë me qëllim të testimit dhe verifikimit të të gjeturave preliminare të hulumtimit.



PLANI PËR PËRZGJEDHJEN E MOSTRËS

Tabela në vijim (Tabela 1) paraqet popullsinë e përgjithshme të Sistemit të Drejtësisë në Kosovë bazuar në numrin e personelit relevant për secilin institucion. Shtylla e katërt (me përqindje) paraqet pjesëmarrjen e institucioneve të identifikuara për qëllime të këtij hulumtimit në Sistemin e Drejtësisë. **Madhësia e përgjithshme e mostrës për këtë studim është 1,100.** Shtylla e fundit paraqet numrin e intervistave të planifikuara për secilin nëngrup bazuar në përqindjen e tyre në sistemin e drejtësisë dhe madhësinë totale të mostrës.

Pas llogaritjes së kuotave të mostrës, numri i intervistave për hetuesit policorë u zvogëluua. Procesi i përzgjedhjes së respondentëve dhe metodologjia për kryerjen e hulumtimit me hetuesit nga Policia e Kosovës ndryshon nga grupet e tjera të respondentëve për shkak të kërkesës së veçantë nga krerët e Policisë së Kosovës. Kjo çështje do të diskutohet më poshtë nën seksionin për kufizimet e këtij studimi.




TABELA 1: NUMRI I PËRGJITHSHËM I ZYRTARËVE TË SISTEMIT TË DREJTËSISË NË KOSOVË

Nr.	Institucioni	Korniza e mostrës	%	Madhësia e mostrës
1	Gjykatësit	326	9.5	105
2	Personeli i gjykatave	693	20.2	222
3	Avokatët	714	20.8	229
4	Prokurorët	165	4.8	53
5	Personeli i zyrave të prokurorisë	272	7.9	87
6	Hetuesit policorë	1,200	35.0	385
7	Hetuesit e Inspektoratit Policor	61	1.8	20
GJITHSEJ		3,431	100	1,100





250 INTERVISTA

Tabela më poshtë paraqet mostrën përfundimtare të rillogaritur të popullsisë për grupet e ndryshme brenda sistemit të drejtësisë, pjesëmarrjen e tyre si dhe madhësinë korresponduese të mostrës, pasi ishte ndarë numri prej **250 intervistash** për hetuesit policorë.

TABELA 2: NUMRI I RI-LLOGARITUR I INTERVISTAVE PËR GRUPET E NDRYSHME BREDA SISTEMIT TË DREJTËSISË

Nr.	Institucioni	Korniza e mostrës	%	Madhësia e mostrës
1	Gjykatësit	326	14.6	124
2	Personeli i gjykatave	693	31.1	264
3	Avokatët	714	32.0	272
4	Prokurorët	165	7.4	63
5	Personeli i zyrave të prokurorisë	272	12.2	104
6	Hetuesit policorë	61	2.7	23
GJITHSEJ		2,231	100	850

TABELA 3: KUOTA PËR HETUESIT POLICORË

Nr.	Institucioni	Korniza e mostrës	%	Madhësia e mostrës
7	Hetuesit policorë	1,200	N/A	250





TESTIMI DHE VALIDIMI I INSTRUMENTIT TË ANKETËS

KDI organizoi fokus grupe me përfaqësues të grupeve të ndryshme brenda Sistemit të Drejtësisë për të marrë reagimet e tyre dhe për të adaptuar pyetësonin e IBA-së në kontekstin lokal të Kosovës.²⁵ Pas finalizimit të pyetësonit, “UBO Consulting” bëri testimin e pyetësonit, i cili mundësoi validimin dhe besueshmërinë e anketës dhe adresimin e sfidave që dolën gjatë administrimit të pyetësorve testues.²⁶



Pas finalizimit të pyetësonit, “UBO Consulting” bëri testimin e pyetësonit, i cili mundësoi validimin dhe besueshmërinë e anketës dhe adresimin e sfidave që dolën gjatë administrimit të pyetësorve testues.

ANKETIMI

Ekipi i UBO-së²⁷ zhvilloi punët në terren ndërmjet datave 4 prill dhe 18 maj 2017 në institucionet qendrore dhe lokale në mbarë Kosovën. Gjatë kësaj kohe, mbikëqyrësit kanë mbajtur kontakte të rregullta me intervistuesit dhe kanë ofruar këshilla për tejkalimin e suksesshëm të sfidave me të cilat ballafaqoheshin ata gjatë punës në terren me qëllim të përmbylljes me sukses të procesit të anketimit.

Respondentët e secilit nëngrup u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme nga listat e zyrtarëve të siguruara nga secili institucion. Anketuesit gjithashtu u pajisën me lista rezervë, në rast se të intervistuarit e përzgjedhur nuk mund të kontaktoheshin. Për gjashtë nëngrupet e para, anketa u krye duke përdorur metodën strikte anonime, ku të intervistuarve të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme iu dorëzua një pyetësor i shtypur në letër me udhëzime të qarta lidhur me qëllimin dhe procesin e plotësimit të pyetësonit, si dhe natyrën anonime dhe rreptësisht konfidenciale të procesit. Pas përfundimit, pyetësori u administrua nga vetë respondentit duke e kthyer atë në një zarf të mbyllur te anketuesi.

Një javë pas fillimit të procesit të anketës, personeli i UBO filloi futjen e të dhënave në bazën e të dhënave. Tabelat e mëposhtme (tabela 4 dhe 5) paraqet rezultatin e punës në terren.

25 Reagimet e ekspertëve nxitën modifikime të gjuhës së anketimit, duke përfshirë: redaktimin ose riformulimin e pyetjeve, dhe shtimin/ndërrimin e filtrave në disa pyetje. Faza e finalizimit të pyetësonit prodhoi versionet përfundimtare të pyetësonit të anketës në tri gjuhë. Ndryshimet në pyetje u pasqyruan në tri gjuhët: anglisht, shqip dhe serbisht.

26 Më konkretisht, testimi është kryer për qëllimet e mëposhtme: 1. Identifikimi i gabimeve të mundshme logjike; 2. Identifikimi i gabimeve thelbësore që lidhen me formulimin e pyetjeve dhe përgjigjeve në pyetësor; 3. Shtimi i filtrave në pyetje të caktuara në rast nevojë; 4. Matja e kohës së nevojshme për të përfunduar me sukses një intervistë.

27 Ekipi i punës në terren përbëhej nga 23 anketues (19 shqiptarë dhe 4 serbë), 8 koordinatorë rajonalë (7 shqiptarë dhe 1 serb) dhe 1 kontrollues teknik. Meqenëse studimi përfshinte individë serbë, UBO Consulting gjithashtu rekrutoi intervistuesit, të cilët janë folës amë të gjuhës serbe, për të siguruar shkallë të lartë përgjigjesh mes individëve. Të gjithë intervistuesit kanë qenë me kualifikim të lartë.





TABELA 4: REZULTATET E PUNËS NË TERREN PËR ANKETËN

Institucioni	N	%
Intervistat e përfunduara	1,050	69.6
Respondentët e paarritshëm (pushim vjetor, nuk ishin në zyrë, etj.)	79	5.2
Refuzimet për shkak të mungesës së kohës	178	11.8
Refuzimet për shkak të përmbajtjes së pyetësorit	137	9.1
Intervistat e ndërprera	29	1.9
Intervistat e ndërprera për shkak të mungesës së kohës	18	1.2
Intervistat e pavlefshme	17	1.1
GJITHSEJ	1,508	100

TABELA 5: INTERVISTAT E PËRFUNDUARA (ZBËRTHYER SIPAS POSTEVE TË RESPONDENTËVE)

Nr.	Institucioni	Madhësia e mostrës	Intervistat e përfunduara
1	Gjykatësit	124	114
2	Personeli i gjykatave	264	255
3	Avokatët	272	259
4	Prokurorët	63	58
5	Personeli i zyrave të prokurorisë	104	102
6	Hetuesit policorë	23	23
6	Hetuesit e Inspektoratit Policor	250	239
	GJITHSEJ	1,100	1,050



KUFIZIMET DHE PENGESAT

Anketa u përball me disa vështirësi në terren përkitazi me përfundimin e intervistave të caktuara. Rezistenca e shprehur nga respondentët u tejkalua me komunikim të vazhdueshëm që synonte të informonin pjesëmarrësit me rëndësinë e projektit. Duke pasur parasysh se këto pengesa u kapërcyen plotësisht dhe nuk e penguan procesin, ndikimi i tyre në këtë proces vlerësohet si i papërfillshëm.

Kufizimi kryesor i anketës, i cili duhet të theksohet, është mënyra e kryerjes së anketës me Policinë e Kosovës. Ky institucion fillimisht hezitoi të bëhej pjesë e IISD-së dhe kundërshtoi dorëzimin e listave të punonjësve të tyre, të cilët do të përdorëshin për zgjedhjen e rastësishme të respondentëve. Duke pasur parasysh rëndësinë e jashtëzakonshme të Policisë së Kosovës në Sistemin e Drejtësisë, ekipi i projektit u detyrua të bënte disa kompromise në mënyrën e zhvillimit të anketës për të siguruar pjesëmarrjen e zyrtarëve të Policisë në hulumtim.

Përzgjedhja e mostre së respondentëve nga grupet e tjera është bërë në mënyrë plotësisht të rastësishme duke u bazuar në listat e plota të zyrtarëve të punësuar në institucionet përkatëse. Pas procesit të përzgjedhjes, anketuesit tanë kontaktuan respondentët dhe u ofruan informata rreth anketës dhe pyetjeve të pyetësorit. Pasi të anketuarit shprehnin vullnetin e tyre për t'u bërë pjesë e anketës, atij/asaj i dorëzohej pyetësori të cilin ata duhej ta plotësonin vetë pa dhënë informata personale që do të bënte të mundur identifikimin e tyre. Pyetësori i kompletuar kthehej tek anketuesit e UBO-së në një zarf të mbyllur.

Kjo procedurë u modifikua për anketimin e Policisë së Kosovës. Duke pasur parasysh refuzimin e tyre për të na dhënë listat e plota të zyrtarëve, anketuesit tanë zhvilluan takime me kryekomandantët e policisë të secilit rajon. Gjatë takimit, personeli i UBO-së dorëzoi kopjet e pyetësorit të shtypura në letër, si dhe detajet rreth numrit të pyetësorëve të cilat duhej të plotësoheshin. Më pas, zyrtari policor shpërndante pyetësorët te kolegët e tij. Me të përfunduar të anketimit, anketuesi i UBO-së njoftohej se mund të vinte të merrte pyetësorët. Mungesa e përzgjedhjes së rastësishme si dhe mungesa e transparencës në administrimin e anketës me Policinë e Kosovës paraqesin kufizime të konsiderueshme për të dhënat e marra nga ky grup dhe atë kryesisht në besueshmërinë dhe vërtetësinë e tyre.

AKTIVITETET PËRCJELLËSE KËRKIMORE

KDI zhvilloi një analizë cilësore të gjetjeve kërkimore të nxjerra nga anketa për të evituar rastet kur të dhënat rreth perceptimit të sjelljeve korruptive nga respondentët mund të ishin të ekzagjeruara apo edhe të minimizuara. Kjo ishte arsyeja kryesore që aktivitetet përcjellëse kërkimore ishin të rëndësishme për të ngritur nivelin e vlefshmërisë së gjetjeve.

1 Fokus grupet e zhvilluara pas përfundimit të anketës me grupe të ndryshme të akterëve (p.sh. institucionet e drejtësisë, institucionet e pavarura, komuniteti i biznesit dhe organizatat e shoqërisë civile) kanë mundësuar që të dhënat e mbledhura të analizohen nga një perspektivë tjetër dhe kjo mund të shpjegojë disa ndryshime në gjetjet tona në krahasim me rezultatet e anketës.

2 Intervistat individuale me akterë të ndryshëm të sistemit të drejtësisë shërbyen si një metodë e vlefshme për të kuptuar më mirë perceptimin, kuptimin dhe përvojat e njerëzve me integritetin në sistemin e drejtësisë në Kosovë.

3 Takimet regjionale të tipit “**Bench Bar**” (aktivitetet i rregulltë i Odës së Avokatëve të Kosovës) gjatë të cilave gjykatësit, prokurorët, policët dhe avokatët e një regjioni shtjellojnë tema të rëndësishme që kanë të bëjnë me drejtësinë dhe sundimin e ligjit u shfrytëzuan për të prezentuar rezultatet preliminare të hulumtimit dhe për të mbledhur komentet dhe sugjerimet e tyre.

SHPREHJET DHE PËRKUFIZIMET E PËRDORURA GJATË ANKETËS

Me qëllim që respondentët të kuptojnë njëllor pyetësorin e IISD-së, KDI-ja në fillim të pyetësorit përfshiu një listë të përkufizimeve për shprehjet juridike të përdorura në pyetësor:

- **Sistemi i drejtësisë** definohet si sistemi që ndërlidhet ose ka të bëjë me gjykatat, prokurorinë, avokatët, institucionet përgjegjëse për administrimin e drejtësisë (Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës) si



dhe njësitë hetues të policisë dhe rolin e tyre në procedimin e rasteve penale.

- **Korrupsioni** në sistemin e drejtësisë nënkupton të gjitha format e ndikimit të papërshtatshëm që mund të dëmtojnë paanësinë e drejtësisë dhe mund të përfshijë cilindo prej akterëve brenda sistemit të drejtësisë, duke përfshirë (por pa u kufizuar në) gjyqtarët, prokurorët, avokatët, inspektoratin e policisë, palët dhe nëpunësit publik.

➤ **Ryshfeti është definuar si:**

- Premtimi, ofrimi ose dhënia, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e një përfitimi të parregullt një zyrtari publik, për vetë zyrtarin apo për një person ose subjekt tjetër, në mënyrë që ai/ajo të veprojë ose të mos veprojë në ushtrimin e detyrave të tij/saj zyrtare;
- Kërkimi ose pranimi i një përfitimi të parregullt nga ana e një zyrtari publik, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, për vete apo për persona ose subjekte të tjera, në mënyrë që ai/ajo të veprojë ose të mos veprojë në ushtrimin e detyrave të tij/saj zyrtare.²⁸

- **Zhvatja** përkufizohet si akt ryshfeti me veprime shtesë. Përderisa kërkimi i mitos është akti i kërkimit ose joshjes së tjetrit, ky veprim bëhet zhvatje kur kërkesa shoqërohet me kërcënim që rrezikon reputacionin personal, integritetin ose jetën e akterëve të përfshirë.²⁹

- Ndikimi politik përkufizohet si manipulimi i politikave, institucioneve dhe rregullave të procedurës, duke përfshirë, por jo ekskluzivisht, ndarjen e burimeve dhe financimin nga vendimmarrësit politikë dhe institucionalë, të cilët abuzojnë me pozitën e tyre për të mbështetur fuqinë, statusin dhe pasurinë e tyre. Në këtë kontekst, "vendimmarrësit" përfshijnë udhëheqësit politikë dhe vendimmarrësit brenda sistemit të drejtësisë.³⁰

- **Keqpërdorimi i fondeve** përkufizohet si akt i një personi që mban pozitë zyrtare në një institucion, organizatë ose kompani dhe që në mënyrë të pandershme dhe ilegale përvetëson, përdor ose trafikon fonde publike, prona publike ose pasuri publike, drejtpërdrejt ose tërthorazi për pasurimin personal (ose pasurimin e të tjerëve) ose aktivitete të tjera.

- **Favorizmi dhe nepotizmi** (favorizimi familjar) konsiderohet si ndërhyrje në drejtësi, sepse i ofrojnë përparësi të padrejtë dikujt që nuk e meriton domosdoshmërisht këtë trajtim.³¹

- **Autoritetet rregullatore** u referohen agjencive të pavarura rregullatore përgjegjëse për autoritet autonom mbi fushat specifike të veprimtarisë njerëzore në një kapacitet rregullator ose mbikëqyrës (në sektorët si: konkurrenca, hekurudha, energjia, komunikimet postare etj.).³²

- **Hetuesit** janë zyrtarët që kryejnë një hetim ose marrin në pyetje palët nën hetim. Për qëllimet e këtij hulumtimi, kjo kategori mbulon një gamë të gjerë të hetuesve të tjerë, si inspektorët e administratës tatimore, inspektorët doganorë dhe hetuesit nga agjencitë e pavarura si Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) gjersa hetuesit policorë janë të përfshirë në kategorinë e veçantë të policisë.

- **Kontestet tregtare** nënkuptojnë kontestet e natyrës tregtare ose afariste që përfshijnë bizneset.³³

- **Kontestet administrative** nënkuptojnë kontestet e natyrë administrative në lidhje me ushtrimin e autoritetit publik.

- **Kontestet e statusit civil** nënkuptojnë kontestet që lidhen me statusin personal të një individi, si divorci, kujdestaria ose konteste të tjera të së drejtës familjare.³⁴

28 Shoqata Ndërkombëtare e Avokatëve (2016), Iniciativa për Integritet Gjiqësor, faqe 11

29 Po aty, faqe 12

30 Po aty, faqe 12

31 Nadler J. dhe Schulman M. "Favoritizmi, Kronizmi dhe Nepotizmi", Santa Clara University (2006)

32 Williams G. D. "The EU's independent agencies: institutionalising responsible European governance" ("Agjencitë e pavarura të BE-së: institucionalizimi i qeverisjes përgjegjëse të BE-së?") Në: Political Studies, vëll. 53, nr. 1, 01.03.2005, f. 82-99.

33 Shoqata Ndërkombëtare e Avokatëve (2016), Iniciativa për Integritet Gjiqësor, faqe 12

34 Po aty



TË GJETURAT KËRKIMORE DHE ANALIZA

Korrupsioni në sistemin e drejtësisë ndikon seriozisht në besimin e qytetarëve ndaj sistemit dhe mund të rrezikojë legjitimitetin dhe stabilitetin e institucioneve demokratike. Edhe pse sistemi i drejtësisë dhe akterët brenda atij sistemi luajnë rol kyç në luftimin e korrupsionit, ata vetë janë të ekspozuar rrezikut të paraqitjes së praktikave korruptive. Për shkak të fokusit shumë të ngushtë dhe qëllimit të hulumtimit të IISD-së, është e nevojshme të krahasohen këto gjetje me studimet e tjera me qëllim që të ndihmojnë në kontekstualizimin e vëzhgimeve tona mbi sjelljen e akterëve kryesorë brenda sistemit të drejtësisë.

Studimet mbi integritetin në sistemin e drejtësisë kanë zbuluar se një nga sfidat kryesore të çdo sistemi të drejtësisë është gjetja e ekuilibrit optimal ndërmjet pavarësisë së gjyqësorit dhe përgjegjshmërisë/ llogaridhënies. Ky balanc është thelbësor për të mbrojtur profesionistët gjyqësorë nga ndikimi i papërshtatshëm i çfarëdo natyre gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Nga ana tjetër, është esenciale ndërtimi i mekanizmave adekuat të monitorimit dhe transparencës për të siguruar që sjelljet e akterëve të drejtësisë janë konform standardeve më të larta të paanshmërisë dhe drejtësisë. Sipas IBA-së (2016), disa shtete gjatë ndërtimit të sistemeve të drejtësisë kanë vënë theksin te përgjegjshmëria e gjyqësorit ndërsa të tjerët kanë shkruar dispozita që favorizojnë pavarësinë e tij. Disa sisteme që favorizojnë llogaridhënien, zgjedhjen e gjyqtarëve e bëjnë përmes votimit popullor, i cili gjithmonë ngërthen në vete rrezikun e ndërhyrjeve politike për shkak se kandidati për gjyqtarë duhet të sigurojë përkrahjen e një subjekti politik për kandidaturën e tij, ndërsa sistemet që theksojnë pavarësinë bëjnë emërimet të përjetshme të gjyqtarëve, duke rrezikuar paraqitjen e fenomenit të “mbylljes në vete” të sistemit gjyqësor.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton në një masë të madhe pavarësinë e sistemit të drejtësisë. Ajo kërkon që gjykatësit dhe prokurorët të jenë të pavarur dhe të paanshëm në ushtrimin e funksioneve të tyre. Gjyqtarët emërohen për jetë dhe nuk u lejohe të bashkohen me ndonjë aktivitet apo subjekt politik. Megjithatë, sistemi i drejtësisë ka vuajtur nga ndërhyrja e qeverisë. Meqë katër (4) prej nëntë (9) anëtarëve të tij zgjedhen nga Kuvendi i Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) është subjekt i rrezikut të manipulimeve politike. Procesi i planifikimit të buxhetit ka qenë gjithashtu nën kontrollin e plotë të qeverisë, me fjalë të tjera, qeveria ka pasur autoritetin përfundimtar për të

vendosur se sa mund të marrë dhe të shpenzojë çdo vit KGJK-ja. Për më tepër, ka pasur raste kur qeveria ka shkuar aq larg sa ka kryer transaksione nga llogaria e KGJK-së pa ndonjë miratim apo informim të Këshillit.³⁵

Ky seksion i raportit do të japë një analizë të plotë të rezultateve të hulumtimit. Ai është organizuar në nën-seksione si në vijim për të pasqyruar strukturën e pyetësorit të përdorur në këtë hulumtim:

- 1 Niveli i perceptimit të sjelljes korruptive
- 2 Format e sjelljes korruptive
- 3 Aktorët e sjelljes korruptive
- 4 Ndërmjetësit e sjelljes korruptive
- 5 Rezultatet e synuara
- 6 Grupet e prirura për korrupsion
- 7 Nxitjet për korrupsion
- 8 Fazat e procesit gjyqësor
- 9 Rreziqet e korrupsionit

³⁵ Instituti Demokratik i Kosovës, Raporti i Vlerësimit të Sistemit Kombëtar të Integritetit, tetor 2015, faqe 66

TË GJETURAT KRYESORE

1

Perceptimi i përgjithshëm i nivelit të korrupsionit në sistemin e drejtësisë është më i ulët **(58.5% e respondentëve)** në krahasim me nivelin e përgjithshëm të korrupsionit në Kosovë **(79.4% e respondentëve)**.

2

Favorizimi / nepotizmi (52.9%) dhe **ndërhyrja politike (50.4%)** janë dy format më të zakonshme të sjelljes së korruptuar në sistemin e drejtësisë

3

Avokatët perceptohen si ndërmjetësit më të shpeshtë **(14.9%)** pasuar nga **anëtarët e familjes (9.0%), miqtë (7.5%)** dhe **zyrtarët e partive politike (7.2%)**

4

Prokurorët **(44.4%)** shihen si më të ekspozuar ndaj nxitjeve për sjellje korruptive që vijnë nga kontaktet e drejtpërdrejta me palët e interesuara jashtë sistemit të drejtësisë (aktorët politikë dhe krimi i organizuar).

5

Si dy qëllimet më të synuara përmes sjelljes korruptive perceptohen a) Përzgjedhja e një gjykatësi dhe prokurorëve të preferuar për të vendosur rreth një rasti / veprimi ligjor **(54.9%)** dhe b) marrja e aktgjykimit të preferuar **(53.3%)**.

6

Dy grupet më të zakonshme të qytetarëve të prirur për sjellje korruptive janë qytetarët e pasur, politikanët aktualë dhe zyrtarët qeveritarë.

7

Format më të shpeshta të nxitjes për të marrë pjesë në kryerjen e akteve të korrupsionit në Kosovë janë përfitimet materiale (për veten, anëtarët e familjes ose komunitetin profesional) me **46.7%** dhe mbajtja e raporteve të mira me aktorët politikë që do të çonin në shpërblime përmes emërimeve dhe mungesa e mbikëqyrjes së pavarur (nga 8% secila prej tyre).

8

Në lidhje me fazat e procesit gjyqësor, respondentët perceptojnë të cenueshëm ndaj korrupsionit çdo fazë të procedimeve **(19%)**. Akti final (shqiptimi i dënimit) perceptohet si më i ndjeshëm ndaj korrupsionit **(16.9%)**, pasuar nga caktimi i prokurorit **(15%)** dhe caktimi i gjyqtarit për rastin **(14.8%)**.

9

Tre faktorët më të rëndësishëm prapa rreziqeve të korrupsionit në sistemin e drejtësisë në Kosovë janë qëllimi i politikanit për të mbuluar sjelljen e tij korruptive **(15.4%)**, pasuar nga interesa të përbashkëta ndërmjet anëtarëve të krimit të organizuar dhe grupeve të biznesit me politikanë të caktuar **(12.3%)**.





1. NIVELI I KORRUPSIONIT TË PERCEPTUAR



Literatura e shqyrtuar gjatë këtij studimi sugjeron se në vendet ku niveli i korrupsionit është i lartë dhe i përhapur gjithandej mbizotëron perceptimi se edhe sistemi i drejtësisë është i korruptuar. Rezultatet e anketës tregojnë se profesionistët e sistemit të drejtësisë e perceptojnë nivelin e përgjithshëm të korrupsionit në Kosovë si shumë të lartë. 79.4 për qind e respondentëve e konsiderojnë atë si të mesëm, të lartë apo shumë të lartë (shih tabelën 6).

TABELA 6: PERCEPTIMI I NIVELIT TË PËRGJITHSHËM TË KORRUPSIONIT NË KOSOVË

Përgjigja	Shpeshtësia	Përqindja (%)
Shumë i ulët	68	6.5
I ulët	109	10.4
Mesatar	387	36.9
I lartë	324	30.9
Shumë i lartë	122	11.6
Pa përgjigje	40	3.8
GJITHSEJ	1,050	100.0





Në pyetjen rreth perceptimit të tyre për nivelin e korrupsionit në sistemin e drejtësisë në Kosovë, rezultatet e anketës tregojnë se 58.5% e respondentëve e konsiderojnë atë si të mesëm, të lartë ose shumë të lartë (shih tabelën 7). Krahasuar me përgjigjet në pyetjen mbi nivelin e perceptuar të korrupsionit në shoqërinë kosovare (79.4 për qind), sistemi i drejtësisë perceptohet si "më pak i korruptuar".

TABELA 7: PERCEPTIMI I NIVELIT TË KORRUPSIONIT NË SISTEMIN E DREJTËSISË


Opsioni	Shpeshtësia	Përqindja (%)
Shumë i ulët	67	6.4
I ulët	115	11.0
Mesatar	302	28.8
I lartë	230	21.9
Shumë i lartë	82	7.8
GJITHSEJ	213	20.3
Pa përgjigje	41	3.9
GJITHSEJ	1,050	100.0



Gjatë analizës së rezultateve në bazë të përvojës së punës së respondentëve, të dhënat tregojnë se 56.3% të profesionistëve në fillim të karrierës (me 0-4 vite përvojë pune), 66.2% të atyre në mes të karrierës (10-19 vjet) dhe 55.4% të atyre me 20-29 vjet vite shërbimi e perceptojnë nivelin e sjelljeve korruptive në sistemin e drejtësisë si të mesëm, të lartë dhe shumë të lartë, ndër-

kohë që sa më e gjatë periudha e shërbimit në drejtësi aq më pak të vetëdijshëm për sjelljen e korruptuar ose më pak të gatshëm të pranojnë se sjellja e tillë ekziston në sistemin e drejtësisë. Këto gjetje janë shqetësuese pasi që dëshmojnë perceptimin negativ të fillestarët dhe të profesionistët e nivelit të mesëm të cilët paraqesin boshtin kurrizor dhe udhëheqësinë e ardhshme të sistemit të drejtësisë.


TABELA 8: PERCEPTIMI I NIVELIT TË KORRUPSIONIT NË SISTEMIN E DREJTËSISË (ZBËRTHIMI SIPAS VITEVE TË PËRVOJËS SË PUNËS)



Analiza e mëtejme e të dhënave duke marrë për bazë profilin e respondentëve tregon se hetuesit policorë, avokatët dhe inspektorët e policisë janë tre grupet me perceptimin më të lartë të sjelljeve korruptive në sistemin e drejtësisë. Një përmbledhje e rezultateve për secilën kategori profesionistësh është paraqitur në figurën 1. Siç shihet nga figura, 79.5% e policëve hetues, 70.3% e avokatëve dhe 65.2% e inspektorëve të policisë perceptojnë korrupsionin si mesatar, të lartë ose shumë të lartë. Në anën tjetër, gjyqtarët dhe personeli i gjykatave tregojnë nivele më të ulëta të të perceptimit të korrupsionit me


34.2% dhe 38.8% respektivisht. Këto të dhëna sugjerojnë se korrupsioni mund të jetë më pak mbizotërues në fazën e gjyqimit sesa në fazat e hershme të procesit gjyqësor siç janë fazat hetimore dhe prokuroriale. Kjo çështje kërkon vazhdim të diskutimit në forume homogjene profesionale (p.sh. policët hetues, prokurorët dhe gjyqtarët veç e veç) si dhe në aktivitete me pjesëmarrje të aktorëve të ndryshëm brenda sistemit të drejtësisë (p.sh. aktivitete regjionale të tipit Bench-Bar) për të përcaktuar nëse gjasat për shfaqjen e korrupsionit ndryshojnë në faza të ndryshme përgjatë “zinxhirit” të procesit penal.

FIGURA 1: PERCEPTIMI I NIVELIT TË KORRUPSIONIT NË SISTEMIN E DREJTËSISË (ZBËRTHIMI SIPAS PROFESIONISTËVE TË SISTEMIT GJYQËSOR)



|||||

Sidoqoftë, kur respondentët u pyetën për përvojën e tyre personale të ballafaqimit me ndonjë person që punon brenda ose që ka lidhje me sistemin e drejtësisë në Kosovë dhe është i përfshirë në çfarëdo forme të sjelljes korruptive (mito, zhvatje, ndikim politik ose keqpërdorim i fondeve), vetëm 24% konfirmuan të kenë pasur ballafaqim të tillë, 61% janë përgjigjur se kurrë nuk kanë pasur përvojë të tillë, ndërsa 15% e respondentëve kanë refuzuar të japin ndonjë përgjigje. Këto rezultate tregojnë një nivel të caktuar të konsistencës me rezultatet e Pulsit Publik të UNDP-së në pyetjen lidhur me faktorët që formojnë perceptimin e qytetarëve mbi praninë e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet vendore dhe ndërkombëtare në Kosovë. Të gjeturat e UNDP-së tregojnë se pothuajse gjysma (49%) prej tyre krijuan mendimet e tyre përmes: mediave të shkruara dhe elektronike, bisedave me miqtë dhe të afërmit (34%). Megjithatë, vetëm 12% e respondentëve deklaruan se ata kanë krijuar mendimet e tyre në bazë të përvojave personale, ku për të marrë shërbime të caktuara, atyre u janë kërkuar para, dhurata ose ndonjë favor tjetër (Pulsi Publik XII nga UNDP, nëntor 2016).



Instituti Demokratik i Kosovës e konsideron këtë fakt si një nga gjetjet kryesore të këtij hulumtimi. Mëdyshja dhe pasiguria nga ana e respondentëve ka qenë veçori që e ka përcjellur anketimin gjatë gjithë fazës së punës në terren. Kjo ka bërë që të konkludojmë se shoqëria kosovare në përgjithësi dhe aktorët brenda sistemit të drejtësisë në veçanti nuk janë ende të gatshëm të diskutojnë haptazi për sjelljet korruptive dhe të trajtojnë këtë fenomen shkatërrues për sistemin e drejtësisë. Ky fenomen ka efekt të dyfishtë negative:

- 1 Krijon bindje të përgjithshme negative për sistemin e drejtësisë dhe perceptim të fryrë për korrupsionin, edhe kur nuk ka dëshmi apo përvoja të tilla për ta mbështetur atë dhe
- 2 Rritë rrezikun që palët ndërgjyqëse ose profesionistët e sistemit të drejtësisë të përfshihen në sjellje korruptive për shkak të bindje të krijuara për sistemin e korruptuar dhe një palë ndërgjyqëse mund të ofrojë para, të cilat një profesionist i drejtësisë kurrë nuk i ka kërkuar.

2. FORMAT E KORRUPSIONIT

Anketa e IBA-së mat perceptimin e nivelit të katër formave të ndryshme të korrupsionit (mitoja, ndërhyrja politike, zhvatja dhe keqpërdorimi i fondeve publike). Bazuar në informatat e mbledhura nga pjesëmarrësit fokus grupeve të mbajtura para zhvillimi të anketës, KDI dhe OAK vendosën të shtojnë kategorinë e pestë: favorizimin dhe nepotizmin. Përderisa IBA i trajton këto dy forma të korrupsionit nën keqpërdorimin e fondeve publike (p.sh. gjyqtarët që punësojnë anëtarët e familjes për të plotësuar personelin e gjykatave ose zyrave të tyre) vendimi për ta shtuar atë si kategori të veçantë u arsyetua plotësisht nga rezultatet e anketës të cilat vendosin favorizimin dhe nepotizmin si formën më të shpeshtë të korrupsionit në sistemin e drejtësisë në Kosovë.

Tabela më poshtë (tabela 9) paraqet të përmbledhura rezultatet e përgjigjeve në pyetjen lidhur me shkallën e incidencës së llojeve të formave korruptive në sistemin e drejtësisë në Kosovë (qoftë drejtpërdrejt apo nëpërmjet një ndërmjetësi). Tabela paraqet shpërndarjen e frekuencës së opsioneve "i mesëm", "i lartë" dhe "shumë i lartë" dhe përmbledh këto tre opsione nën shtyllën e fundit. Kur krahasohen dhe analizohen rezultatet nga shtylla e fundit, forma më e shpeshtë e korrupsionit është favorizimi dhe nepotizmi (38.5 për qind), pasuar nga ndërhyrja politike (34.8 për qind) dhe mitoja (23.9 për qind).



TABELA 9: FORMAT E SJELLJES KORRUPTIVE NË SISTEMIN E DREJTËSISË NË KOSOVË

Opsioni	I lartë (%)	Shumë i lartë (%)	Totali (%)
Favorizimi / Nepotizmi	21.5	17.0	38.5
Ndërhyrja politike	20.6	14.2	34.8
Mito	16.9	7.0	23.9
Keqpërdorimi i fondeve	16.1	7.3	23.4
Zhvatja	12.9	5.5	16.4

Rezultati i analizës sipas profesionit të respondentit është paraqitur në tabelën në vijim (tabela 10). Vlerat e paraqitura përfshijnë shpërndarjen e opsioneve "i zakonshëm" dhe "shumë i zakonshëm". Të dhënat kon-

firmojnë se favorizimi / nepotizmi dhe ndërhyrja politike janë dy shprehjet më të shpeshta të korrupsionit, në të gjitha profesionet në kuadër të sistemit të drejtësisë përveç avokatëve.

TABELA 10: FORMAT E SJELLJES KORRUPTIVE DHE AKTORËT E SEKTORIT GJYQËSOR

Opsioni	Gjyqtarët	Avokatët	Prokurorët	Hetuesit policor	Personeli gjyqësor	Personeli Prokurorial
Favorizimi/ Nepotizmi	27.8	21.3	25.3	13.0	21.2	18.0
Ndërhyrja politike	26.0	18.2	24.2	12.7	13.9	13.4
Mito	16.9	22.3	15.3	9.5	11.0	8.0



2.1 FAVORIZIMI DHE NEPOTIZMI

Kjo formë e korrupsionit, e njohur edhe si favorizim i drejtuar nga lidhjet familjare, përkufizohet si ndërhyrje, sepse përdoret për të evidentuar rastet e ofrimit të avantazheve të papërshtatshme për dikë që nuk e meriton këtë trajtim. Rezultatet e anketës ofrojnë dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar përcaktimin e pjesëmarrësve gjatë konsultimeve të para-anketës për ta shtuar atë në kontekstin kosovar. Më shumë se gjysma e respondentëve (52.90%) e perceptojnë favorizimin dhe nepotizmin si format më të zakonshme të korrupsionit në Kosovë. Përderisa ky lloj i sjelljes korruptive nuk perceptohet si i lidhur drejtpërdrejtë me rezultatin e shqyrtimit gjyqësor të rasteve, ai perceptohet si i domosdoshëm gjatë përshejtit të procedurave gjyqësore gjatë shqyrtimit të rasteve (28% e respondentëve e shohin përshejtimin e shqyrtimit të rasteve gjyqësore si rezultat të dëshiruar). Një respondent duke u përgjigjur në një pyetje të hapur të anketës deklaroi se "Nepotizmi është mjet për punësim, shqiptim të dënimeve më të lehta, parashkrim të rasteve gjyqësore, vonesë të qëllimshme si dhe moszbatim të vendimeve gjyqësore".

Kjo nxjerr në pah temën e përsëritur të raportit mes integritetit, besnikërisë ndaj familjes (klanit apo fisit) dhe institucioneve shtetërore. Van de Haar (2013) në studimin e saj që synonte të përgjigjej në pyetjen se kujt i drejtohen njerëzit për siguri njerëzore në shoqëritë e prekura nga konflikti dhe ato në tranzicion, thekson "rëndësinë e aranzhimeve institucionale autoktone, jo-shtetërore për t'u kujdesur për disa nga funksionet që shteti "jo i plotë" nuk mund t'i përmbush". Një avokat i Kosovës nuk e konsideron daljen në një drekë me një gjyqtar "për hir të miqësisë së tyre nga ditët e shkollës" si një konflikt të mundshëm interesi edhe nëse ata diskutojnë çështje apo problematika që i përfshijnë të dytë.³⁶

Me qëllim të adresimit të këtyre dukurive, ndër masat që mund të merren parasysh nga institucionet gjegjëse mund të radhiten:

- 1 Përpilimi i rregullave të qarta kundër konfliktit të interesit dhe transparencën si dhe planit pë zbatimin e tyre;
- 2 Emërimi dhe avancimi i gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit gjyqësor e prokurorial të bazuar në sistemin e meritave profesionale;

36 Intervistë me një avokat, 26 korrik, 2017

- 4 Përpilimi i kritereve të qarta dhe objektive për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit të tyre mbështetës;
- 5 Sistem më rigoroz të vlerësimit të performancës dhe sanksionimit për sjellje të të papra-nueshme apo shpërblimit gjatë performancës së mirë.

2.2 NDËRHYRJA DHE NDIKIMI POLITIK

Literatura e shqyrtuar ofron shembuj të mjaftueshëm se si aktorët e ndryshëm brenda dhe jashtë sistemit të drejtësisë synojnë të ushtrojnë ndikim të paligjshëm në procesin gjyqësor³⁷. Rrezik permanent në sistemin e drejtësisë paraqet tendenca, që zakonisht vijnë nga niveli politik për të dobësuar autonominë e tij. Të cenuara nga ky rrezik janë sidomos procedurat e emërimit dhe avancimit, procedurat e caktimit të buxhetit dhe procedurat mbikëqyrëse.

Më pak se një e pesta e pjesëmarrësve në anketë shfrytëzuan rastin për t'u përgjigjur në pyetjet e hapura si pjesë të pyetësorit. Ato pak komente të mbledhura nga respondentët ofrojnë indikacione të mjaftueshme për ndikimin e paligjshëm politik në procedurat gjyqësore. Komentet si: "*Kur politika troket në dritare, drejtësia del nga dera*"³⁸; "*Peshqit e mëdhenj në det, kurse të vegjlit në tigan*"³⁹; "*Gjatë shqyrtimit gjyqësor të rastit, një telefonatë nga ndonjë politikan mund të bëjë ndryshimin*"⁴⁰ nuk kërkojnë më shumë shpjegim.

Raporti i IBA-së (2016) sugjeron që rrjetet shoqërore joformale të bazuara në përkatësinë familjare, politike, etnike apo lloje tjera të lidhjeve depërtojnë në të gjithë sektorët publikë dhe privatë dhe veprojnë në të gjithë sektorët e qeverisjes, në botën e biznesit, në politikë dhe në sistemin e drejtësisë. Përgjigjet e pjesëmarrësve të anketës tregojnë ekzistimin e këtyre rrjeteve joformale. "Ka ndikim politik dhe kryesisht bëhet duke emëruar njerëz të lidhur me politikën në pozita të rëndësishme dhe duke mos marrë parasysh profesionistë kompetentë me integritet personal", tha një nga pjesëmarrësit e anketës. "Madje edhe personeli gjyqësor është i punësuar në bazë të lidhjeve të tyre politike

37 Shoqata Ndërkombëtare e Avokatëve (maj 2016), Iniciativa e Integritetit Gjyqësor "Sistemet e Drejtësisë dhe Korrupsioni"

38 Nga një përgjigje e një respondenti nga Anketa IIGJ e kryer në Kosovë (prill-maj 2017)

39 Nga një përgjigje e një respondenti nga Anketa IIGJ e kryer në Kosovë (prill-maj 2017)

40 Nga një përgjigje e një respondenti nga Anketa IIGJ e kryer në Kosovë (prill-maj 2017)



në mënyrë që ata të mund të kenë më shumë ndikim më vonë" është përgjigja e një pjesëmarrësi tjetër në pyetjen ku kërkohet të përshkruhen mekanizmat e ndërhyrjes politike në sistemin e drejtësisë në Kosovë. Një prokuror, duke iu përgjigjur kësaj pyetjeje, tha qartë: "Ju lutemi referojuni rastit të emërimit të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore" (duke mos specifikuar se për cilën Prokurori e kishte fjalën).

Në vitin 2015, Komisioni Evropian për Zgjerim e përshkroi Sistemin e Drejtësisë të Kosovës si sistem i cili ndodhet në "fazë të hershme të zhvillimit... dhe i prirur për ndërhyrje politike". Kjo përshtypje është krijuar nga disa organizata ndërkombëtare gjatë viteve të veprimit të tyre në Kosovë dhe në raportet e tyre shpesh theksojnë rreziqet thelbësore të korrupsionit në sistemin e drejtësisë në Kosovë të nxitura nga mungesa e pavarësisë në vendimmarrje dhe vendosmërisë nga ana e aktorëve të drejtësisë për të ushtruar kompetencat e tyre përkatëse në luftën kundër korrupsionit. Procesi i emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve gjithashtu ndikohet nga ndarjet politike. Raporti gjithashtu thekson administrimin e dobët të drejtësisë dhe llogaridhënien e pamjaftueshme të personelit administrativ.

2.3 RYSHFETI

Bazuar në raportin e IBA-së (2016), ryshfeti duket të jetë shumë i zakonshëm në sisteme të ndryshme të drejtësisë. Fshehja ose keqpërdorimi i provave, pas marrjes së shumës së kërkuar të parave, është njëra nga format e tilla. Në anën tjetër, rezultatet e anketës sonë flasin për formën e ryshfetit gjatë procesit të përzgjedhjes së gjyqtarëve të preferuar me qëllim të arritjes së rezultatit të preferuar në një rast penal (21.1% e respondentëve) dhe rezultatit të preferuar në mosmarrëveshje tregtare (18.2% e respondentëve).

Raporti i njëjtë përshkruan se si gjyqtarët dhe avokatët pranojnë ryshfet nga aktorë politikë, avokatë, palë ndërgjyqëse – veçanërisht kur interesat ekonomike të një kompanie janë në pyetje - ose aktorë tjerë të jashtëm, me qëllim të manipulimit me provat e mbledhura ose ofrimin të "shërbimeve" tjera. Në këtë raport, avokatët perceptohen se luajnë rol aktiv të ndërmjetësit gjatë sjelljeve korruptive, duke kërkuar nga klientët e tyre të paguajnë tarifa shtesë në mënyrë që të ushtrohet ndikim në vendimmarrjen e aktorëve tjerë në sistemin e drejtësisë.


Rezultatet e anketës tregojnë se respondentët tanë e perceptojnë përfshirjen e gjyqtarëve dhe avokatëve në sjelljen korruptive të ryshfetit në nivel pothuajse të njëjtë (39.1% dhe 40.2% respektivisht). Në një nivel më të ulët (34.6 për qind) perceptohen prokurorët të cilët gjithashtu mund të kërkojnë ryshfet për të vonuar ose për të përshpejtuar procedimin e rastit. Siç raportohet, prokurorëve u ofrohet ryshfet kryesisht për të manipuluar me prova, siç janë dokumentet dhe raportet policore, për të humbur dokumentet, për të pranuar/mohuar në mënyrë të paligjshme ofertat për pranimin e fajësisë ose për të ndërhyrë në procesin e hetimit. Në bazë të të dhënave të anketës, rreth 28% e respondentëve e perceptojnë personelin e gjykatës si nismëtar të sjelljeve korruptive brenda sistemit. Kur iu kërkua që të ofrojnë më shumë hollësi për rolin e personelit gjyqësor, ata i përshkruajnë ata si ndërmjetës në mes të gjykatësit dhe palëve ndërgjyqëse. Në pyetjen e njëjtë, një prokuror i ri ngriti një sërë pyetjesh retorike: "Çfarë niveli të edukimit ka personeli gjyqësor? Prej nga vijjnë ata? Si janë punësuar ata? Cila ishte baza e tyre ekonomike para punësimit të tyre? Çfarë standardi të jetesës kanë ata sot?" Ky lloj qëndrimi tregon nivel të lartë mosbesimi ndërmjet akterëve të ndryshëm të sistemit të drejtësisë dhe veçanërisht ndërmjet gjyqtarëve/prokurorëve dhe personelit përkatës administrativ. Për të adresuar këtë mungesë besimi, kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët duhet të bëjnë përpjekje që përmes aktiviteteve të ndryshme që ndihmojnë punën ekipore dhe komunikimin e brendshëm (siç janë mbledhjet e rregullta të personelit por dhe aktivitetete tjera jashtë orarit zyrtar të punës) të ndërtojnë besimin e ndërsjelltë profesional.

3. NDËRMJETËSIT E SJELLJES SË KORRUPTUAR

Pjesëmarrësve në anketë gjithashtu u është kërkuar të ofrojnë informata rreth perceptimit të tyre të përfshirjes së ndërmjetësve (palëve të jashtme) gjatë inicimit të sjelljeve korruptive në sistemin e drejtësisë në Kosovë. Nga personat e anketuar, 39.8 për qind prej tyre konsiderojnë se ndërmjetësit janë të pranishëm gjatë inicimit të sjelljeve të tilla në sistemin gjyqësor të Kosovës. Si ndërmjetës më të shpeshtë konsiderohen avokatët (14.9 për qind) pasuar nga familjarët e palëve ndërgjyqëse (9.0 për qind), miqtë (7.5 për qind) dhe zyrtarët



TABELA 11: NDËRMJETËSIT E SJELLJES KORRUPTIVE



politikë (7.2 për qind). Pasi u analizuan përgjigjet në pyetjen e hapur në lidhje me ndërmjetësit, mund të konstatohet se një formë e përhapur e këtyre veprimeve është zhvatja e shumave të parave nga klientët, me gjasë për tu përdorur në fazat e mëvonshme në formë të dhënies së ryshfetit për gjyqtarët apo prokurorët, varësisht fazës në të cilën ndodhet rasti. Këto pretendime nga pjesëmarrësit në anketë edhe një herë theksojnë rëndësinë e vendosjes së linjave më të mira të komunikimit ndërmjet institucioneve të sistemit gjyqësor, prokurorial dhe Odës së Avokatëve të Kosovës me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të dukurive të tilla.

Analizat më të hollësishme të rezultateve të anketës japin rezultate interesante mbi atë se si grupet e ndryshme të profesionistëve brenda sistemit të drejtësisë i perceptojnë ndërmjetësit e sjelljes korruptive. Përderisa 15.8 për qind e gjyqtarëve dhe 15.5 për qind e prokurorëve i perceptojnë avokatët në rolin e ndërmjetësve, vetë avokatët, në pyetjen e njëjte, i shohin anëtarët e familjes (12.7 për qind) dhe miqtë (11.6 për qind) si ndërmjetës. Një e gjetur interesante që rezultoi nga kjo analizë është se 27.2 për qind e hetuesve policorë i perceptojnë avokatët si ndërmjetësit më të shpeshtë. Kjo gjetje ka nevojë për hulumtim të mëtejshëm për të përcaktuar nëse ky perceptim vjen:

- a** nga keqkuptimi i tarifave që kërkohen ligjshëm nga avokatët;
- b** nga një grupi i vogël i avokatëve që veprojnë si ndërmjetës për të korruptuar të tjerët apo
- c** avokatët që përfshihen në zhvatjen e klientëve duke pretenduar të jenë ndërmjetës dhe në vend të kësaj përvetësojnë gjithë shumën për vete.

Oda e Avokatëve të Kosovës duhet të ndërmarrë veprime për të adresuar këtë perceptim dhe të mbledhë fakte lidhur me këtë gjetje. Nëse rasti nën (a) është më i zakonshëm, atëherë ata duhet të informojnë profesionistë të tjerë të sistemit të drejtësisë për tarifën e avokatëve që të shmangen rezultate të tilla gjatë hulumtimeve që mund të zhvillohen në të ardhmen. Nëse rastet nën (b) dhe nën (c) janë më të zakonshme, atëherë duhet të ndërmirren hapa ndëshkues me qëllim të eliminimit të këtyre sjelljeve.

Studime të ngjashme të kryera në vendet me nivel të lartë të korrupsionit në sistemin e drejtësisë sugjerojnë se palët ndërgjyqëse përdorin ndërmjetësit për ta anashkaluar burokracinë e tepruar të në sistemin e drejtësisë. “Ata preferojnë të përdorin ndërmjetës në vend që të ofrojnë ryshfet drejtpërsëdrejti për shkak të pasigurisë mbi atë se cilët zyrtarë janë të korruptuar (pranojnë një ofertë ryshfeti) dhe sa ryshfet duhet t’u jepet zyrtarëve të korruptuar” (Bayar, 2003).

4. NDËRVEPRIMET NDËRMJET PROFESIONEVE TË NDRYSHME

4.1 NDËRVEPRIMET E GJYQTARËVE ME PROFESIONISTË TJERË TË SISTEMIT TË DREJTËSISË

Të dhënat e anketës tonë sugjerojnë që gjyqtarët nuk janë imunë ndaj sjelljes korruptive. Sa i përket ndërveprimit me profesionistët tjera, gjyqtarët më së shpeshti u drejtohen gjyqtarëve tjerë, me incidencën më të lartë të raportuar (34.3 për qind), prokurorëve (31.20 për qind) dhe avokatëve (30.9 për qind). Gjyqtarët gjithashtu perceptohen si të përfshirë në sjellje korruptive të iniciuar nga profesionistë tjerë të sistemit të drejtësisë (30.9 për qind të iniciuar nga avokatët dhe 26.3 për qind nga prokurorët). Të gjithë pjesëmarrësit në anketë janë të vetëdijshëm për rolin e gjyqtarët si figurën kryesore në sistemin e drejtësisë. Ky fakt i bën gjykatësit jashtëzakonisht “tërheqës” për palët e tjera në përpjekjet e tyre për të korruptuar procesin e vendimmarrjes.

Në përgjithësi, gjetjet e anketës tonë janë në përputhje të plotë me gjetjet e Raportit të IBA-së se gjykatësit perceptohen të angazhohen më së shpeshti në sjellje korruptive në ndërveprimet e tyre me gjykatësit dhe avokatët tjerë, që tregon se një sjellje e tillë është kryesisht e fokusuar në ndërveprimet e brendshme në kuadër të sistemit të drejtësisë.

4.2 NDËRVEPRIMET E AVOKATËVE ME PROFESIONE TJERA GJYQËSORE

Sipas raportit të IBA-së (2016) për shkak të privilegjit profesional që gëzojnë, si pjesë e raporteve me klientët e tyre, avokatët u ekspozohen një numri të madh rreziqesh korruptive. Raporti vazhdon më tutje se, megjithëse është një parakusht thelbësor për avokatët që të përmbushin mandatin e tyre dhe të këshillojnë klientët

në interesin më të mirë të tyre, në të njëjtën kohë, mungesa e transparencës gjatë këtij komunikimi mund të përdoret për të fshehur sjelljet që, edhe pse mund të jenë në përputhje me ligjin, mund të jenë jo etike.

Gjithsej, 30.9 për qind e respondentëve janë të mendimit se avokatët janë grupi që kanë gjasat më të mëdha të iniciimit të sjelljeve korruptive gjatë ndërveprimit të tyre me grupet tjera brenda sistemit të drejtësisë. Kjo sjellje korruptive më së shpeshti shfaqet gjatë ndërveprime me avokatë të tjerë (32.6 për qind), gjyqtarë (30.9 për qind) dhe prokurorë (28 për qind). Bazuar në të dhënat e anketës, avokatëve më së shpeshti u drejtohen avokatët tjerë (32.6 për qind), gjykatësit (30.9 për qind) dhe prokurorët (28 për qind).

Përveç kësaj, rezultatet e anketës gjithashtu tregojnë se avokatët, për shkak të natyrës së punës së tyre, ndërveprojnë më shpesh dhe në mënyrë më të drejtpërdrejtë me palët e treta dhe kanë gjasat që të shërbejnë si ndërmjetës janë më të larta. Sa i përket formave të sjelljeve korruptive, ryshfeti del si forma më e zakonshme e sjelljes korruptive të avokatët (40.2 për qind të respondentëve). Disa pjesëmarrës gjatë aktiviteteve të organizuara pas kryerjes së anketimit kanë përshkruar raste kur kërkesat për ryshfet nga avokatët janë bërë në emër të akterëve tjerë të sistemit të drejtësisë (kryesisht në emër të gjyqtarëve dhe, më rrallë, prokurorëve). Ky fakt kërkon hulumtim më të thellë dhe do të duhej të shërbente si paralajmërim për nevojën imediate për bashkëpunim më të thellë ndërmjet institucioneve gjyqësore, prokuroriale dhe Odës së Avokatëve.

4.3 NDËRVEPRIMI I PROKURORËVE ME PROFESIONET TJERA TË SISTEMIT TË DREJTËSISË

Kur prokurorët janë perceptuar si iniciues të sjelljeve korruptive nga pjesëmarrësit në anketën tonë, këto janë përshkruar si raste kur prokurori i afrohet prokurorëve të tjerë (29.8 për qind), avokatëve (28.1 për qind) dhe gjyqtarëve (26.3 për qind). Rreziku i ndikimit së palës së tretë tek prokurorët është gjithashtu i lartë. Fakti që 44.4% e respondentëve i konsiderojnë prokurorët si grup që nuk janë imunë ndaj sjelljeve korruptive (kryesisht përmes favorizimit dhe nepotizmit) tregon se prokurorët janë në rrezik të vijnë drejtpërdrejt në kontakt me akterët jashtë sistemit të drejtësisë (kryesisht akterë politikë dhe pjesëtarë të grupeve të krimit të organizuar).

4.4 NDËRVEPRIMI I PERSONELIT GJYQËSOR ME PROFESIONET TJERA TË SISTEMIT TË DREJTËSISË

Personeli gjyqësor është identifikuar nga pjesëmarrësit në anketë si grupi i katërt më i prirur për përfshirje në sjellje korruptive. 21 për qind e respondentëve e perceptojnë personelin gjyqësor si iniciues të sjelljeve korruptive gjatë ndërveprimeve të tyre me profesione tjera brena sistemit të drejtësisë. Këto sjellje më së shumti iniciohen gjatë ndërveprimit me kolegët e tyre nga personeli gjyqësor (21.7 për qind), me gjyqtarët (21 për qind) dhe me avokatët (20.3 për qind).

Në lidhje me motivimin për përfshirje në sjellje të tilla, personeli thuhet se kërkon të nxjerrë përfitime materiale duke premtuar një proces gjyqësor më të shpejtë. Sondazhi ynë jep indikacione të kufizuara për sjelljen korruptive në mesin e personelit gjyqësor, por disa të intervistuar kanë ofruar informata interesante për rolin e tyre në përsheptimin e rasteve gjyqësore, duke bashkëpunuar drejtpërdrejt me gjyqtarët ose duke ndërhyrë në nivelin më të lartë (d.m.th. presidentin e gjykatës) i cili më vonë do t'i paralajmëronte gjyqtarët për të përsheptuar shqyrtimin e rastit.

TABELA 12: REZULTATET E SYNUARA

Ryshfeti	Ndikimi politik	Zhvatja	Favorizimi/ nepotizmi
1. Të arrihet një rezultat i preferuar në rastet penale	Të përzgjidhet një gjyqtar i preferuar për të vendosur një rast	Të arrihet një rezultat i preferuar në rastet penale	Të përzgjidhet një gjyqtar i preferuar për të vendosur një rast
2. Të përzgjidhet një gjyqtar i preferuar për të vendosur një rast	Të arrihet një rezultat i preferuar në rastet penale	Të përzgjidhet një prokuror i preferuar për një çështje penale	Të arrihet një rezultat i preferuar në rastet penale
3. Të përzgjidhet një prokuror i preferuar për një rast penal	Të përzgjidhet një prokuror i preferuar për një çështje penale	Të përzgjidhet një gjyqtar i preferuar për të vendosur një rast	Të përzgjidhet një prokuror i preferuar për një rast penal
4. Të vonohen ose përshejtohen procedurat gjyqësore	Të vonohen ose përshejtohen procedurat gjyqësore	Të vonohen ose përshejtohen procedurat gjyqësore	Të vonohen ose përshejtohen procedurat gjyqësore

5. REZULTATET E SYNUARA

Ky seksion i pyetësorit synon të masë rezultatet e synuara përmes katër formave më të shpeshta të sjelljes korruptive – pjesë e këtij studimi (ryshfeti, ndikimi politik, zhvatja dhe favorizimi/nepotizmi). Anketa tregon se pavarësisht nga forma e sjelljes korruptive, rezultatet më të shpeshta të synuara janë përpjekjet (shih tabelën 12):

- 1 për të arritur një rezultat të preferuar gjatë shqyrtimit të rasteve penale
- 2 për të zgjedhur gjykatësin e preferuar për të gjykuar rastin
- 3 për të zgjedhur prokuror e preferuar të rastit
- 4 për të vonuar ose përsheptuar procedurat gjyqësore



Përzgjedhja e gjykatësit apo prokurorit të preferuar për të vendosur një rast apo për të ndërmarrë një veprim ligjor konsiderohet si rezultati më së shumti i synuar përmes formave të lartpërmendura të sjelljeve korruptive (54.9% dhe 53.3% respektivisht). Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të ndërmarrë veprime për të instaluar sistemin e ndarjen e rastësishëm të rasteve dhe për të ofruar informata më të mira profesionistëve të sistemit të drejtësisë dhe publikut rreth procedurave ekzistuese. KGJK-ja gjithashtu duhet të informojë profesionistët brenda sistemit të drejtësisë dhe publikun rreth masave për parametrave sipas të cilave mund të modifikohen ndarjet e rastësishme të rasteve, sidomos rregullat e konfliktit të interesit dhe rregullat e konsolidimit të rasteve për qëllime efikasiteti. Gjithashtu KGJK-ja duhet të publikoj rregullat e përgjithshme dhe rastet e veçanta të ri-ndarjes së rasteve për të parandaluar dyshimet për veprim të korruptuar prapa ndryshimeve në emërimet e gjyqtarëve të rasteve. Në këto raste, Këshilli duhet të potencojë se ndryshimet bëhen pikërisht për të parandaluar shfaqjen e sjelljeve korruptive. Caktimet fillestare të një gjyqtari ose prokurori duhet të bëhen përmes një sistemi elektronik dhe e njëjta mund të korrigjohet apo rregullohet nga gjykata për të shmangur konfliktet e mundshme të interesit apo për të lejuar që rastet e ndryshme por të ndëlidhura mes vete të trajtohen nga gjyqtari i njëjtë.

6. GRUPET E PRIRURA PËR KORRUPSION

Perceptimi i të anketuarve për grupet e qytetarëve që kanë më shumë gjasa të përdorin një formë të sjelljes korruptive kur kanë të bëjnë me sistemin e drejtësisë në Kosovë është paraqitur në tabelën 13. Pyetja e njëjtë u parashtrua në mënyrë individuale për secilin grup dhe përmes shkallës atitudinale të anketuarit iu ofruan opsionet duke filluar nga “shumë pak gjasa” në “ka shumë gjasa”. Vlerat e përqindjeve të prezentuara në kolonën e djathtë të tabelës më poshtë janë shuma e përqindjeve për opsionet *ka gjasa* dhe *shumë gjasa*.

TABELA 13: GRUPET E PRIRURA NDAJ KORRUPSIONIT

Grupet	Përqindja (%)
Zyrtarët aktualë të qeverisë	54.5
Politikanët aktualë	53.1
Qytetarët e pasur	53.0
Anëtarët e organizatave kriminale	47.4
Korporata të mëdha kombëtare	46.4
Ish zyrtarë të qeverisë	43.4
Ish politikanë	42.7

Kur krahasohen grupet e prirura për korupsion dhe llojet e sjelljeve korruptive, rezultatet e anketës tregojnë se zyrtarët qeveritarë i realizojnë qëllimet e tyre përmes ndikimit politik (njëjtë si politikanët dhe ish zyrtarët qeveritarë), ndërsa qytetarët e pasur kryesisht ofrojnë ryshfet si një mënyrë për realizimin e qëllimit të tyre. Zhvatja më së shpeshti përdoret nga anëtarët e organizatave kriminale. Këto të gjetura janë të harmoni të plotë me fuqinë e pritshme ose potencialin ndikues të secilit prej grupeve individuale.

Më shumë se gjysma e të anketuarve (54.5 për qind) u përgjigjën se zyrtarët e tanishëm të qeverisë janë të prirur të shfrytëzojnë ndonjërin prej formave të sjelljeve korruptive kur kanë të bëjnë me sistemin e drejtësisë dhe ky trend vazhdon edhe pasi ky zyrtar humb pozitën e tij (43.4 për qind të respondentëve mendojnë se ish-zyrtarët qeveritarë vazhdojnë të ushtrojnë ndikim në sistemin e drejtësisë përmes lidhjeve të krijuara gjatë kohës së mandatit të tyre). Lidhur me grupet e tjera të prirura për korupsion, qytetarët e pasur janë zgjedhur nga 53.0% e respondentëve. Një nga pjesëmarrësit e anketës deklaroi se “këto dallime dëmtojnë parimin e barazisë së qytetarëve para ligjit. Një i dyshuar që jeton me ndihma sociale nuk mund të presë trajtim të barabartë me një palë tjetër ndërgjyqëse që i përket klasës më të lartë shoqërore”.



7. NXITËSIT E SJELLJEVE KORRUPTIVE

Përmbledhja e rezultateve nga pyetjet në lidhje me perceptimet për nxitësit e sjelljeve korruptive dhe cënueshmërinë e profesionistëve të sistemit të drejtësisë në përfshirjen në veprime korruptive është ilustruar në tabelën e mëposhtme:

TABELA 14: NXITJET PËR KORRUPSION

Nxitësit	Përgjigjet në total	Përqindja
Përfitime materiale - për veten, për një ose më shumë anëtarë të familjes ose për komunitetin e profesionistit	490	46.7
Mbajtja e marrëdhënieve të mira me aktorët politik	83	7.9
Mungesa e mbikëqyrjes së pavarur	80	7.6
Shpërblimet përmes emërimeve	79	7.5
Frika e humbjes së vendit të punës	74	7.0

Në nivel të përgjithshëm, nxitësi më i shpeshtë për t'u përfshirë në veprime korruptive në Kosovë është përfitimi material për veten, anëtarët e familjes ose për komunitetin e profesionistit (46.7%). Si nxitës tjerë, edhe pse në nivel shumë më të ulët se nxitësi kryesor, renditen mbajtja e marrëdhënieve të mira me aktorët politikë që do të çonin në shpërblime nëpërmjet emërimeve të ardhshme të karrierës dhe mungesa e mbikëqyrjes së pavarur (me rreth 8% të respondentëve secila).

Këto rezultate u krahasuan me të gjeturat rreth grupeve të qytetarëve të prirura për korrupsion (shih seksionin 6) të cilët përdorin ndonjë formë të sjelljes korruptive kur kanë të bëjnë me sistemin e drejtësisë. Rezultatet për qytetarët e pasur që janë identifikuar nga 62.4% e respondentëve si grupi më i zakonshëm për të iniciuar korrupsionin në sistemin e drejtësisë përputhen me nxitësin më të shpeshtë – përfitimi material për veten, anëtarët e familjes ose të tjera. Më tutje gjatë këtij krahasimi, rezultatet për zyrtarët e tanishëm qeveritarë të identifikuar si shumë të prirur për të iniciuar sjellje korruptive përmes ndikimit të papërshtatshëm politik janë

krahasuar me synimin e akterëve të sistemit të drejtësisë për mbajtjen e marrëdhënieve të mira me aktorët politikë dhe shpërblimet përmes emërimeve.

8. FAZAT E PROCESIT GJYQËSOR

Një nga qëllimet e anketës së IISD-së ishte identifikimi i fazës së procedurave gjyqësor më e cënueshme ndaj sjelljes korruptive. Tabela më poshtë paraqet rezultatet e përmbledhura për përgjigjet “shpesh” dhe “shumë shpesh”. Bazuar në rezultatet e anketës, 19.0% e respondentëve e konsiderojnë procesin gjyqësor të cënueshëm gjatë gjithë fazave të tij. Kur u pyetën për fazat specifike të procesit gjyqësor, akti përfundimtar (shqiptimi i dënimit) është perceptuar nga 16.9% e respondentëve të jetë më i cënueshëm ndaj formave të korrupsionit pasuar nga caktimi i prokurorit të rastit



(15.0%), caktimi i gjyqtarit të rastit (14.8%) dhe aktakuza (në procesin penal) me 14.52 për qind. Shih tabelën 15.

TABELA 15: FAZAT E PROCESIT GJYQËSOR

Faza e procesit gjyqësor	Përqindja (%)
Procesi gjyqësor në tërësi	19.0
Shqiptimi i dënimit	16.9
Caktimi i prokurorit të rastit	15.0
Caktimi i gjyqtarit të rastit	14.8
Aktakuza (në procesin penal)	14.2
Faza e hetimeve	13.7
Procedura gjyqësore	13.6
Zbatimi i vendimeve	13.5

Zgjidhjet e mundshme që mund të merren parasysh nga aktorët kyç të sistemit të drejtësisë janë veprimet konkrete që synojnë të rrisin transparencën në proceset gjyqësore, monitorimin e gjykimit dhe pjesëmarrjen publike në seanca dëgjimore. Të gjitha këto veprime drejt rritjes së transparencës gjatë procedurave gjyqësore duhet të zhvillohen në formën e udhëzimeve për dënimin/akuzimin me qëllim të zvogëlimit të diskrepancave.

Sa i përket llojeve të rasteve në procesin gjyqësor, rastet penale janë më të cenueshme ndaj sjelljes korruptive (24.1 për qind) pasuar nga rastet civile (21.8 për qind) dhe rastet ekonomike (21.5 për qind). Shih tabelën 16.

TABLE 16: LLOJET E RASTEVE NË PROCESIN GJYQËSOR

Llojet e rasteve	Përqindja (%)
Rastet penale	24.1
Rastet e përgjithshme civile	21.8
Rastet ekonomike	21.5
Rastet e pronës	20.1
Rastet financiare dhe tatimore	18.7
Kundërvajtjet/Shkeljet e vogla	12.6
Rastet administrative	12.4
Procedura e zbatimit	10.8
Rastet e falimentimit	10.6
Rastet lidhur me ligjin mbi punën dhe pensionet	10.4
Rastet familjare	9.7
Raste mjedisore	7.7

Literatura sugjeron që rreziqet e ndryshme lindin dhe palët e ndryshme janë më së shumti të cenueshme në faza të ndryshme të procesit: para se një rast/ lëndë të arrijë në gjykatë⁴¹. Avokatët, prokurorët dhe hetuesit policorë janë më të cenueshmit pasi ata e ndërtojnë rastin. Rreziqet përfshijnë ndikimin politik ose rryshfetin për të manipuluar me provat dhe akuzat e ngritura para gjykatës. Gjatë procedurave gjyqësore, gjykatësit, avokatët dhe nëpunësit mund të qasen që të ndikojnë në rezultatin e rastit, në vonimin ose përshpejtimin e tij, që të heqin akuzat ose të ndikojnë në vendimin përfundimtar të gjyqtarit.

41 Shoqata Ndërkombëtare e Avokatëve (Maj 2016), Iniciativa e Integritetit Gjyqësor "Sistemet e Drejtësisë dhe Korrupsioni"



9. RREZIQET E KORRUPSIONIT

Tre faktorët më të rëndësishëm prapa rreziqeve të korrupsionit në sistemin e drejtësisë në Kosovë, të perceptuar nga pjesëmarrësit e anketës, janë synimet e politikanëve për të mbuluar sjelljet e tyre korruptive (15.4 për qind), pasuar nga interesat e përbashkëta midis anëtarëve të kimit të organizuar dhe disa politikanëve (12.3 për qind) dhe interesat e përbashkëta të grupeve të biznesit dhe disa politikanëve (11.5 për qind).

TABELA 17: RREZIQET E KORRUPSIONIT

Rreziqet e korrupsionit	Numri i përgjigjeve	Përqindja
Dëshira e figurave politike me ndikim për mbulimin e sjelljes së tyre korruptive	449	15.4%
Interesat e përbashkëta midis anëtarëve të rrjeteve kriminale të organizuara dhe disa politikanëve apo udhëheqësve politikë	360	12.3%
Interesat e përbashkëta të grupeve të biznesit dhe disa politikanëve apo udhëheqësve politik	337	11.5%
Pagat e ulëta	237	8.1%
Mungesa e kapaciteteve profesionale dhe guximit për të luftuar korrupsionin	199	6.8%
Drejtësia jo e shërbyer në kohë	145	5.0%
Drejtësia selektive e shërbyer në formë të faljes së të fuqishmit	124	4.2%
Mekanizmat e dobët të kontrollit të brendshëm dhe rezultatet disiplinore	111	3.8%

Një analizë më e detajuar e rezultateve për opsionin "paga të ulëta" tregon se 96 përgjigje (nga 237) janë dhënë nga personeli gjyqësor dhe i prokurorisë që tregon se personeli gjyqësor dhe prokurorisë nuk janë të kënaqur me nivelin e pagave të tyre dhe e perceptojnë këtë si një rrezik potencial kur sjellja e korruptuar shfaqet në sistemin e drejtësisë.

Favorizmi dhe nepotizmi i ndjekur nga ndërhyrja politike janë format më të zakonshme të korrupsionit të perceptuara nga aktorët e sektorit të drejtësisë. Në

anën tjetër, si nxitësit më të zakonshëm u identifikuan përfitimet materiale (për veten, ose për anëtarët e familjes ose për bashkësinë profesionale), pasuar nga mbajtja e marrëdhënieve të mira me aktorët politikë. Këto gjetje sugjerojnë se ekziston një korrelacion midis këtyre dyjave dhe paraqesin pranojnë një kërcënim serioz për integritetin e sektorit të drejtësisë i cili është shumë i vështirë për t'u zgjidhur.



KONKLUZIONET

Anketa “Iniciativa për Integritetin në Sistemin e Drejtësisë” fillimisht e hartuar dhe e zbatuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Avokatëve (IBA) është konceptuar si një mundësi unike për aktorët e sistemit të drejtësisë që të ndajnë në mënyrë anonime shqetësimet e tyre rreth praktikave korruptive brenda sistemit. Raporti është rezultat i bashkëpunimit në mes të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) dhe Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK) si anëtare e IBA-së. Qëllimi i këtij Raporti është paraqitja e rezultateve të këtij hulumtimi shumëdimensional, i cili përfshin rezultatet e anketës së zhvilluar në nivel kombëtar, fokus grupet e mbajtura pas kryerjes së anketës dhe intervistave individuale me aktorët e sistemit të drejtësisë në Kosovë.

Qëllimet kryesore të anketës ishin identifikimi i formave më të përhapura të sjelljeve korruptive që manifestohen në sistemin e drejtësisë, rreziqet e korrupsionit gjatë ndërveprimit midis aktorëve të ndryshëm në sistemin e drejtësisë, nxitësit e sjelljeve korruptive, ndërmjetësit e veprimeve korruptive dhe rreziqet e sjelljes korruptive që dalin gjatë fazave të ndryshme të procedurave gjyqësore. Më poshtë është lista e gjetjeve kryesore të anketës të zhvilluar gjatë muajit prill dhe maj 2017:

- Rezultatet e anketës tregojnë se perceptimi i përgjithshëm i nivelit të korrupsionit në gjyqësor është më i ulët krahasuar me nivelin e përgjithshëm të korrupsionit në Kosovë.
- Favorizimi dhe nepotizmi është forma më e zakonshme e korrupsionit në sistemin e drejtësisë në Kosovë. "Nepotizmi është një mjet për sigurimin e vendit të punës, për t'u shqiptuar dënime më të lehta, për të shkaktuar vonesa të qëllimshme dhe parashkrim të rastit dhe për të siguruar moszbatimin e aktgjyqimeve gjyqësore."⁴²
- Meqë papunësia përgjithësisht konsiderohet të jetë problemi më sfidues social dhe ekonomik, hulumtimi ynë zbulon se perspektivat e punësimit të juristëve në sistemin e drejtësisë komprometohen nga korrupsioni.
- Aktorë të ndryshëm nga brenda dhe jashtë sistemit të drejtësisë ushtrojnë ndikim të jashtëligjshëm mbi procesin gjyqësor. Ky fenomen e vë në rrezik pavarësinë e përgjithshme të sistemit të drejtësisë.

- Përfitimet materiale për veten ose anëtarët e familjes janë nxitësit më të shpeshtë për përfshirje në aktet korruptive në Kosovë. Rrjedhimisht, qytetarët e pasur janë grupi më i zakonshëm për të iniciuar korrupsionin në sistemin e drejtësisë përmes nxitësit më të zakonshëm.
- Sa i përket sjelljeve korruptive gjatë ndërveprimit midis aktorëve të ndryshëm të sistemit të drejtësisë, gjyqtarët më së shpeshti u drejtohen gjyqtarëve tjerë, avokatët kanë më shumë gjasa të iniciojnë sjellje të korruptuar në ndërveprimet e tyre me avokatë dhe gjyqtarë të tjerë, ndërkohë që prokurorët perceptohen të iniciojnë sjellje korruptive me prokurorë të tjerë.
- Personeli gjyqësor perceptohet si grup që synon të nxjerrë përfitime materiale duke premtuar proces gjyqësor më të shpejtë.
- Avokatët, për shkak të natyrës së profesionit të tyre dhe kontakteve të tyre të rregullta me palët e treta, janë më të prirur për të shërbyer si ndërmjetës dhe të ndikojnë në rezultatin e rasteve.
- Përzgjedhja e gjyqtarit dhe prokurorit të preferuar për të vendosur një rast përmes ndërhyrjes politike konsiderohet rezultati më i synuar gjatë veprimeve korruptive.
- Qytetarët e pasur dhe zyrtarët e tanishëm të qeverisë kanë më shumë gjasa të përdorin një formë të sjelljes korruptive kur kanë të bëjnë me institucionet gjyqësore.
- Procedurat gjyqësore perceptohen si të cenueshme ndaj korrupsionit në të gjitha fazat e saj. Akti fillestar (ngritja e padisë), caktimi i gjyqtarit, procedimi në gjykatë dhe faza e hetimit konsiderohen më të ndjeshmet.
- Sa i përket llojeve të rasteve në procesin gjyqësor, rastet penale janë më të cenueshme ndaj sjelljes korruptive të ndjekura nga rastet civile dhe rastet ekonomike (36.6 përqind).

KDI dhe OAK do të vazhdojnë të punojnë në adresimin e gjetjeve të IISD-së për të identifikuar dhe zhvilluar, në kontekstin e këtyre gjetjeve, masat e duhura për të ofruar mbështetje për sistemin e drejtësisë me qëllim të përmirësimit të efektivitetit dhe legjitimitetit të procedurave gjyqësore.

42 Nga një intervistë me akterët e sistemit të drejtësisë, qershor 2017





REKOMANDIMET

REKOMANDIMET PËR KGJK-NË, KRYETARËT E GJYKATAVE, GJYKATËSIT DHE PERSONELIN E GJYKATAVE

- 1 KGJK duhet të përdorë kritere objektive, gjithmonë të bazuara në meritë dhe integritet, në procesin e përzgjedhjes së gjyqtarëve dhe personelit të gjykatave.
- 2 KGJK duhet të ushtrojë fuqinë e saj kushtetuese si një degë e pavarur e qeverisë, për të siguruar burime adekuate (buxhet, infrastrukturë fizike dhe burime njerëzore) për gjyqësorin.
- 3 KGJK duhet të ndër marrë veprime të mëtejshme për të avancuar sistemin e përzgjedhjes e rastësishme të gjyqtarëve për rastet nën shqyrtim. Përzgjedhja fillestare e gjyqtarit duhet të bëhet përmes një sistemi elektronik dhe ajo mund të ndryshohet nga gjykata për të shmanhur konfliktet e mundshme të interesit apo për të lejuar që rastet e lidhura të trajtohen nga i njëjti gjyqtar. KGJK duhet të komunikojë arsyet për ri-caktimin e gjyqtarëve në mënyrë që ato të kuptohen drejtë si masa për të parandaluar konfliktet e interesit ose për të përmirësuar efikasitetin dhe jo si mjete për të manipuluar procedimin e rasteve.
- 4 Kryetarët e gjykatave dhe KGJK-ja duhet të mbajnë takime të rregullta me institucionet përgjegjëse për sigurinë e gjykatave dhe të bëjnë shqyrtimin e rregullt të masave të sigurisë. Bazuar në këto analiza, plane të detajuara duhet të përpilohen dhe të përditësohen për të adresuar kërcënimet ekzistuese dhe të ardhshme për sigurinë fizike të aktorëve gjyqësorë.
- 5 Kryetarët e gjykatave duhet të mbajnë mbledhje periodike me gjyqtarët dhe personelin e gjykatave për të shqyrtuar masat që mund të zvogëlojnë ndikimin e jashtëligjshëm, siç janë kufizimi i qasjes së publikut në zyrat private të gjyqtarëve dhe shqyrtimi (skriningu) i të gjitha thirrjeve telefonike ndaj gjyqtarëve.
- 6 KGJK-ja duhet të marrë në konsideratë që trajnimi i vazhdueshëm i edukimit ligjor mbi etikën gjyqësore të bëhet i detyrueshëm në baza periodike të caktuara (p.sh., çdo vit, çdo tre vjet etj.) për gjyqtarët dhe personelin e gjykatave, ngjashëm me programin e edukimit të vazhdueshëm të detyrueshëm ligjor të OAK.
- 7 KGJK duhet të kërkojë trajnim për edukimin ligjor mbi etikën gjyqësore në Akademinë e Drejtësisë për gjyqtarët dhe personelin e gjykatës.
- 8 KGJK duhet të rrisë nivelin e transparencës së procedurave disiplinore në mënyrë që qytetarët të marrin informacion të mjaftueshëm për masat e vendosura për gjyqtarët.
- 9 KGJK ose kryetarët e gjykatave duhet të thërrasin takime diskutimi me gjyqtarët dhe/ose personelin e gjykatës për të diskutuar gjetjet lidhur me rreziqet dhe dobësitë ndaj korrupsionit dhe hartimin e zgjidhjeve të tyre për të balancuar këto perceptime ose për të zbutur këto rreziqe dhe dobësi.
- 10 KGJK-ja duhet të marrë në konsideratë nxjerrjen e publikimit që informon qartë qytetarët për angazhimin etik dhe standardet e zbatueshme për gjyqtarët dhe personelin.
- 11 Gjykatat duhet të konsiderojnë ngritjen e nivelit të komunikimit me publikun për të shpjeguar më mirë procedurat gjyqësore, tarifat e aplikueshme, arsyet për vonesat procedurale dhe çështje të tjera që mund të keqinterpretohen si korrupsion ose të rrisin rrezikun e korrupsionit.



REKOMANDIME PËR KPK-NË, KRYEPROKURORËT, PROKURORËT DHE PERSONELIN E ZYRËS SË PROKURORISË

- 1 KPK duhet të përdorë kritere objektive, gjithmonë të bazuara në meritë dhe integritet, në procesin e përzgjedhjes së prokurorëve dhe personelit të zyrës së prokurorisë.
- 2 KPK-ja duhet të ushtrojë fuqinë e saj kushtetuese si një degë e pavarur e qeverisë, për të siguruar burime adekuate (buxhet, infrastrukturë fizike dhe burime njerëzore) për shërbimin e prokurorisë.
- 3 KPK duhet të ndërmarrë veprime të mëtijshme për të informuar publikun lidhur me caktimin e prokurorëve për rastet. Përderisa, përzgjedhja fillestare e një prokurori është në diskrecionin e Kryeprokurorit, ajo mund të rregullohet nga prokuroria qoftë për të shmangur konfliktet e mundshme të interesit apo për të lejuar që rastet e lidhura të trajtohen nga i njëjti prokuror. Duhet të bëhen përpjekje për t'i komunikuar publikut arsyet për ri-caktimin në mënyrë që ato të kuptohen si masa për të zbutur konfliktet e interesit ose për të përmirësuar efikasitetin dhe jo si mjete për të manipuluar procesimin e rasteve.
- 4 Kryeprokurorët dhe KPK-ja duhet të takohen periodikisht me ata që janë përgjegjës për sigurinë e zyrës së prokurorisë dhe të kryejnë një shqyrtim të masave të sigurisë. Bazuar në këto shqyrtime, plane të hollësishme duhet të përpilohen dhe përditësohen periodikisht për të përballuar kërcënimet ekzistuese dhe të ardhshme për sigurinë fizike të aktorëve prokurorialë.
- 5 KPK-ja duhet të marrë në konsideratë që trajnimi i edukimit të vazhdueshëm ligjor mbi etikën gjyqësore të bëhet i detyrueshëm në baza periodike të caktuara (p.sh., çdo vit, çdo tre vjet etj.) për prokurorët dhe personelin e zyrës së prokurorisë.
- 6 KPK-ja duhet të kërkojë trajnim të edukimit ligjor mbi etikën gjyqësore në Akademinë e Drejtësisë për prokurorët dhe personelin e zyrës së prokurorisë.

- 7 KPK-ja duhet të rrisë nivelin e transparencës së procedurave disiplinore në mënyrë që qytetarët të marrin informacion të mjaftueshëm për masat e vendosura ndaj prokurorëve.
- 8 KPK-ja ose kryeprokurorët duhet të thërrasin takime diskutimi me prokurorët dhe/ose personelin e zyrave të prokurorisë për të diskutuar gjetjet lidhur me rreziqet dhe dobësitë ndaj korrupsionit dhe hartimin e zgjidhjeve të tyre për të balancuar këto perceptime ose për të zbutur këto rreziqe dhe dobësi.

REKOMANDIME PËR OAK-NË, KRYETARËT E DEGËVE TË OAK-SË DHE AVOKATËT

- 1 OAK duhet të rrisë nivelin e transparencës së procedurave disiplinore në mënyrë që qytetarët të marrin informata të mjaftueshme për masat e vendosura për avokatët.
- 2 OAK duhet të marrë masa për të sanksionuar avokatët që veprojnë ose pretendojnë të veprojnë si ndërmjetës për gjyqtarë ose prokurorë
- 3 OAK duhet të thërrasë takime gjyqtarë-avokatë (të ashtuquajturat “Bench-Bar”) të fokusuar në mënyrë specifike në integritet për të inkurajuar zhvillimin e përbashkët të një zotimi në mbështetje të integritetit dhe masave për të zbutur rreziqet dhe dobësitë ndaj korrupsionit si dhe sjelljet e korruptuara faktike ose të perceptuara.

REKOMANDIME PËR POLICINË E KOSOVËS

- 1 Policia e Kosovës duhet të rrisë nivelin e transparencës së procedurave disiplinore në mënyrë që qytetarët të marrin informacion të mjaftueshëm për masat e vendosura për policinë.

BIBLIOGRAFIA

1. Aristoteli (2000), Politika, përkthyer nga B. Jowett, Nju Jork: Dover
2. Bayar, G (2003), "Roli i ndërmjetësve në korrupsion", Public Choice, Springer, Springer
3. Integrity: Doing the Right Thing for the Right Reason. McGill-Queen's University Press. 2010
4. Iniciativa për Integritetin Gjyqësor e Shoqatës Ndërkombëtare të Avokatëve "Sistemet e Drejtësisë dhe Korrupsioni", (maj 2016) zhvilluar në partneritet me Institutin e Baselit për Qeverisje
5. Raporti i Zgjerimit i Komisionit Evropian, Kosova (2015) (European Commission Enlargement Report, Kosovo (2015))
6. Vlerësimi i Sistemit të Integritetit Kombëtar në Kosovë, Instituti Demokratik i Kosovës, tetor 2015
7. Rrjeti Evropian i Këshillave për Gjyqësorin, Pavarësia dhe Përgjegjësitë e Gjyqësorit dhe Prokurorisë: Treguesit e Performancës 2015 (Hagë 2015) www.ency.eu/images/stories/pdf/GA/Hague/ency_report_independence_accountability_2014_2015_adopted_ga.pdf
8. Eurobarometri, Drejtësia në BE, (Flash Eurobarometer 385 2013) http://ec.europa.eu/public_opinion/flash/fl_385_en.pdf (marrë më 10 gusht 2017)
9. IBA, OECD and UNODC, Risks and Threats of Corruption and the Legal Profession (Survey, 2010) (IBA, OECD dhe UNODC, (Rreziqet dhe Kërcënimet e Korrupsionit dhe Profesionit Ligjor (Anketa, 2010))
10. Jennett V, Fighting Judicial Corruption Topic Guide (Transparency International, 2014) (Udhëzues për Luftën kundër Korrupsionit Gjyqësor) www.transparency.org/whatwedo/answer/fighting_judicial_corruption_topic_guide
11. Mann C, Corruption in Justice and Security (U4 Expert Answer, Chr Michelsen Institute 2011) (Korrupsioni në Drejtësi dhe Siguri)
12. Messick R E and Schütte S A, Corruptions Risks in the Criminal Justice Chain and Tools for Assessment (U4 Issue 2015: 6, Chr Michelsen Institute 2015) (Rreziqet e Korrupsionit në Zinxhirin e Drejtësisë Penale dhe Mjetet për Vlerësim)
13. Sossin L, How can greater judicial integrity be achieved (Si mund të arrihet integriteti më i madh gjyqësor)?, Revista Sistemas Judiciales, Centro de Estudios de Justicia de las Américas No.15 (2004)
14. Transparency International America in The Global Corruption Report 2007: Corruption and Justice systems (Cambridge University Press 2007) (Transparency International America në Raportin Global të Korrupsionit 2007: Korrupsioni dhe Sistemet e Drejtësisë)
15. Transparency International, The Global Corruption Report 2007: Corruption and Justice systems (Cambridge University Press, 2007) (Transparency International, Raporti Global i Korrupsionit 2007: Korrupsioni dhe Sistemet e Drejtësisë (Cambridge University Press, 2007)) www.transparency.org/whatwedo/publication/global_corruption_report_2007_corruption_and_judicial_systems
16. Transparency International, Advocacy Toolkit: Combating Corruption in Justice systems (2007) (Transparency International, Seti i mjeteve për Avokim: Luftimi i Korrupsionit në Sistemet e Drejtësisë)
17. Transparency International, Global Corruption Barometer (Barometri Global i Korrupsionit) 2010/11 (2010)
18. Transparency International, Corruption Perceptions Index 2014: Clean Growth at Risk (2014) (Transparency International, Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit 2014: Rritja e pastër në rrezik)
19. United Nations Office on Drugs and Crime, Guide on Strengthening Judicial Integrity and Capacity (2011) World Justice Project, Rule of Law Index (2015) (Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin, Udhëzues për Forcimin e Integritetit dhe Kapacitetit Gjyqësor (2011) Projekti i Drejtësisë Botërore, Indeksi i Sundimit të Ligjit)
20. UNDP "Pulsi publik XII", nëntor 2016
21. Van de Haar Gemma (2013) "State and non-state institutions in conflict-affected societies" ("Institucionet shtetërore dhe jo-shtetërore në shoqëritë e prekura nga konflikti"), Oxfam IS Academy

SHTOJCA 1: LITERATURA E SHQYRTUAR

Gjatë rishikimit të literaturës shqetësimet e ngritura nga IBA se "ekzistojnë një sërë studimesh dhe projektesh që fokusohen në fenomenin e korrupsionit dhe ndikimin që ushtron në sistemin e drejtësisë". Megjithatë, studimet që fokusohen në mënyrë specifike në format e korrupsionit brenda sistemeve të drejtësisë dhe ndërveprimet midis profesionistëve brenda sistemit të drejtësisë janë të kufizuara dhe u mungon qasja e nevojshme gjithëpërfshirëse që do të mbështeste zhvillimin e strategjive anti-korrupsion të bazuara në prova⁴³. Më tutje, raporti i IBA-së thekson programin "Asistenca Teknike e Integritetit Gjyqësor" që UNODC (Zyra kundër Narkotikëve dhe Krimeve pranë Kombeve të Bashkuara) i zbaton në shumë vende të botës dhe i cili, në fazën fillestare të zbatimit, bën vlerësimin gjithëpërfshirës të integritetit dhe kapacitetit të sistemit të drejtësisë.⁴⁴

Shumë autorë e përkufizojnë termin "integritet" në mënyra të ndryshme, por të gjitha ato kanë të përbashkëta konceptin e konsistencës në veprime, vlera, metoda, masa, parime, pritshmëri dhe rezultate. Në etikë, integriteti konsiderohet si ndershmëria dhe vërtetësia apo saktësia e veprimeve të dikujt, është kualifikimi i të qenit i sinqertë dhe me parime të forta morale. Integriteti është një zgjedhje personale, një angazhim i pakompromis dhe parashikueshëm konsistent për të respektuar vlerat dhe parimet morale, etike, shpirtërore dhe artistike (Killinger, 2010). Vetë fjala ka evoluar nga mbiemri latin integer, që do të thotë tërësi ose i plotë.

Në këtë kontekst, integriteti është ndjenja e brendshme e "tërësisë" që rrjedh nga cilësitë si ndershmëria dhe qëndrueshmëria e karakterit. Sistemi i vlerave të një individi siguron një kornizë brenda të cilës individi vepron në mënyra të cilat janë konsistente dhe të pritshme. Integriteti është gjendja e të poseduarit të një kornize të tillë, dhe të vepruarit në harmoni brenda kornizës së dhënë. Integritetit mund t'i jepet një shumëllojshmëri kuptimesh, dhe fushëveprimi i tij mund të ndikohet nga kultura dhe historia, ndër faktorë të tjerë.

Në kontekst gjyqësor, integriteti përfshin ndershmërinë, drejtësinë dhe besimin. Integriteti gjithashtu mund të përkufizohet sipas asaj çfarë nuk është. Kur një person në pozitë të pushtetit vepron për interesin e vet ose për qëllime të fshehta ose të pahijshme, kuptohet gjerësisht se një personi të tillë i mungon integriteti. Në gjithë globin, për shumë dekada, qeveritë punojnë vazhdimisht në ndërtimin një sistem efektiv të drejtësisë që do të mbronte dhe avancoje integritetin gjyqësor. Parimi themelor i etikës gjyqësore (d.m.th. pavarësia gjyqësore) është përmendur në nenin 10 të **Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (1948)**, i cili thekson si në vijim:

Çdokush ka të drejtë në barazi të plotë në një seancë të drejtë dhe publike nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij dhe të çdo akuze penale kundër tij.

I njëjti parim është elaboruar më tej në nenin 14 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, e cila u miratua në vitin 1966, në formulimin e mëposhtëm:

Të gjithë personat janë të barabartë para gjykatave dhe tribunaleve. Në përcaktimin e çdo akuze penale kundër tij, ose të të drejtave dhe detyrimeve të tij në padë në ligj, secili ka të drejtë për një seancë të drejtë dhe publike nga një gjykatë kompetente, e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj.

43 Iniciativa për Integritetin Gjyqësor të Shoqatës Ndërkombëtare të Avokatëve "Sistemet e Drejtësisë dhe Korrupsioni", (Maj 2016), faqe 5

44 Për të konfrontuar korrupsionin gjyqësor, UNODC merr një shumëllojshmëri të qasjeve. Një ekzaminim i detajuar mbi nivelin e korrupsionit pasohet nga përpjekjet e Agjencisë për të identifikuar mjetet e adresimit të tij, në nivelet më të larta dhe më të ulëta të sistemeve të gjykatave. UNODC përdor procesin e mëposhtëm me tre hapa:

1. Formulimi i konceptit të integritetit gjyqësor dhe hartimi i metodologjisë për futjen e këtij koncepti pa kompromentuar parimin e pavarësisë së gjyqësorit.
2. Lehtësimi i një mjedisi i të mësuarit të sigurt dhe produktiv për kryeqytetarët mendjehapur ndaj reformave në të gjithë botën dhe
3. Ngritja e vetëdijes për integritetin gjyqësor dhe zhvillimi, udhëheqja dhe monitorimi i projekteve të asistencës teknike që synojnë forcimin e integritetit dhe kapacitetit të gjyqësorit.

I njëjti parim, si dhe standardet e tjera të rëndësishme që duhet të udhëzojnë sjelljen gjyqësore, më vonë u zgjeruan dukshëm në **Parimet Themelore të Kombeve të Bashkuara mbi Pavarësinë e Gjyqësorit**, miratuar nga Kongresi i Kombeve të Bashkuara më 1985, i cili deklaroi:

1. Pavarësia e gjyqësorit do të garantohet nga shteti dhe mishërohet në Kushtetutë ose në ligjin e vendit. Është detyrë e të gjitha institucioneve qeveritare dhe institucioneve tjera që të respektojnë dhe të vëzhgojnë pavarësinë e gjyqësorit.
2. Gjyqësori vendos çështjet para tyre në mënyrë të paanshme, në bazë të fakteve dhe në përputhje me ligjin, pa ndonjë kufizim, ndikim, nxitje, presion, kërcënim ose ndërhyrje të papërshtatshme, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga kushdoqoftë ose për çfarëdo arsye.
3. Gjyqësori ka juridiksion mbi të gjitha çështjet me natyrë gjyqësore dhe ka autoritet ekskluziv për të vendosur nëse një çështje e paraqitur për vendimin e saj është në kompetencën e saj siç përcaktohet me ligj.
4. Nuk do të ketë ndonjë ndërhyrje të papërshtatshme ose të pajustificuar në procesin gjyqësor, dhe vendimet gjyqësore nga gjykatat nuk do të jenë subjekt i rishikimit. Ky parim nuk paragjkon rishikimin gjyqësor, ose zbutjen nga autoritetet kompetente të dënimeve të shqiptuara nga gjyqësori, në përputhje me ligjin.

Parimet e Bangalorit të Sjelljes Gjyqësore, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Komisionit të të Drejtave të Njeriut të OKB-së në maj 2003, krijuan udhëzimet për sjelljen gjyqësore etike në formë të gjashtë vlerave:

- pavarësia
- paanshmëria
- integriteti
- drejtësia
- barazia
- kompetenca
- zelli

Rajonet e ndryshme anembanë botës kanë përpunuar më tej këto parime duke pasur në mendje vetë traditat dhe historitë e tyre ligjore. Në nivel rajonal evropian, ekzistojnë një numër instrumentesh të rëndësishme që kanë të bëjnë me etikën gjyqësore. Ato janë "**Karta e Gjykatësve në Evropë**" (**Judges' Charter in Europe**) të miratuar më 20 mars 1993 në Wiesbaden (Gjermani) nga Shoqata Evropiane e Gjyqtarëve, i cili është një degë regjionale e Shoqatës Ndërkombëtare të Gjyqtarëve.

Gjyqtari jep llogari vetëm para ligjit. Ai nuk i kushton vëmendje subjekteve politike apo grupeve të presionit. Ai kryen detyrat e tij profesionale pa ndikim të jashtëm dhe pa vonesa të panevojshme (neni 2) dhe se "Gjyqtari jo vetëm që duhet të jetë i paanshëm, ai duhet të shihet nga të gjithë si i paanshëm."

Rekomandimi mbi Pavarësinë, Efikasitetin dhe Rolin e Gjyqtarëve, miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës më 1994 dhe **Karta Evropiane mbi Statutin e Gjyqtarëve** e miratuar nga Këshilli i Evropës në Strasbourg më 1998 zgjerojnë parimin e pavarësisë dhe përgjegjësisë së gjyqtarëve dhe përmbajnë dispozita për parakushtet për sigurimin e pavarësisë së gjyqësorit, duke siguruar metoda të përshtatshme për përzgjedhjen dhe rekrutimin e gjyqtarëve, sigurimin e kushteve të duhura të punës dhe ruajtjen e pavarësisë gjyqësore nga një shoqatë gjyqësore ose organ administrativ.

Parimet e llogaridhënies/ përgjegjshmërisë gjyqësore. Sistemi i drejtësisë duhet të jetë llogaridhënës për efikasitetin e procesit gjyqësor dhe shpenzimet e fondeve publike. Parimet e llogaridhënies gjyqësore përfshijnë:

1. Gjyqtarët duhet të ofrojnë arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre;
2. Vendimet gjyqësore duhet të nxirren në kohën e duhur;
3. Gjyqtarët duhet të veprojnë - dhe të shihen se po veprojnë - në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme;
4. Buxheti dhe shpenzimet e gjykatave duhet të jenë transparente
5. Gjyqtarët duhet të jenë llogaridhënës para publikut dhe interesit publik.



Parimet e pavarësisë gjyqësore. Përderisa llogaridhënia gjyqësore është e rëndësishme, nuk duhet të kuptohet si diçka që i lejon qeverisë apo ndonjë individ, grupi ose organizate të jashtme të ndikojë në vendimmarrjen e gjyqtarëve. Për shembull, Parimet Etike të Kanadasë deklarojnë se "gjyqësori i pavarur është i domosdoshëm për drejtësi të paanshme. Prandaj, gjyqtarët duhet ta ruajnë dhe ilustrojnë pavarësinë e gjyqësorit në aspektin e tij individual dhe atij institucional. "Përderisa sigurimi i një liste të plotë të faktorëve që ndikojnë në pavarësinë gjyqësore në juridiksione të ndryshme duket të jetë i pamundur, në vijim po i japim disa nga tiparet më të rëndësishme të pavarësisë gjyqësore:

- Gjyqtarët nuk duhet të jenë të drejtuar nga politika ose ndërhyrja e Qeverisë në vendimmarrjen gjyqësore;
- Kushtet e punës (siguria e mandatit, kompensimi financiar) vendosen dhe përcaktohen në mënyrë objektive dhe nuk i lihet vendimeve të Qeverisë; dhe
- Disiplina gjyqësore dhe mbikëqyrja e sjelljes gjyqësore kryhet nga gjyqësori.

Roli i degëve të tjera të pushtetit. Degët e tjera të pushtetit (ekzekutivi dhe legjislativi) luajnë rol të rëndësishëm në sigurimin e integritetit gjyqësor, pavarësisë dhe paanshmërisë duke përfshirë:

- Respektimin e pavarësisë së gjyqtarëve në vendimmarrjen e tyre;
- Sigurimin e një mjedisi të qëndrueshëm buxhetor për administrimin e drejtësisë;
- Sigurimin e standardeve më të larta të bazuara në merita në emërimin e gjyqtarëve; dhe
- Krijimin e një procesi të drejtë dhe objektiv, kur është e nevojshme, për largim nga gjyqësori.
- Për aq sa është e mundur, "depolitizimi" i marrëdhënieve midis qeverisë dhe gjyqësorit.

Korrupsioni gjyqësor godet mu në zemër të sundimit të ligjit. Në një vend ku komuniteti i avokatëve dhe qytetarët e humbin besimin në pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit, mund të jetë e vështirë rivendosja e tij. Pasojat janë edhe më afatgjate dhe më të vështira kur ky

fenomen demotivon studentët dhe të diplomuarit në fushën e drejtësisë të ndjekin karrierën e tyre gjyqësore.

Një mjet juridik i rëndësishëm për të adresuar ndikimin e jashtëligjshëm në gjyqësor është skemë e fuqishme e deklarimit të konfliktit të interesit dhe përjashtimit nga rastet kur mund ekziston rreziku nga konflikte të tilla. Me t'u bërë gjyqtarë, individëve mund t'u kërkohej të deklarojnë interesat biznesore dhe ekonomike, si dhe interesat e anëtarëve përkatës të familjes. Kjo kërkesë e deklarimit vjetor mund të jetë një mënyrë e llogaridhënies në sistemin e drejtësisë.

Korrupsioni mund të shkaktohet nga kapja dhe mund të kontribuojë në kapjen e sistemit të drejtësisë nga elitat ekonomike. Ky korrupsion mund të komprometojë edhe pavarësinë e avokatëve dhe aspekteve tjera kryesore në sistemin e drejtësisë. Kapja mund të jetë eksplicite (p.sh. ryshfeti) ose implicite (p.sh. gjyqtarët e lidhur me elitat ekonomike nëpërmjet përvojës dhe perspektivave të përbashkëta).

Përjashtimet dhe konfliktet e interesit. Është zhvilluar debat i gjatë në lidhje me procedurat e duhura që duhet ndjekur kur kërkohet përjashtimi i një anëtari të një jurie të gjyqtarëve, por përgjithësisht pranohet se qasja e duhur do të duhej të ishte që pala të dorëzojë propozimin që do të vendosej nga gjyqtari, përjashtimi i të cilit kërkohet. Kjo mund të shkaktojë disa vështirësi nëse gjyqtari e hedh poshtë kërkesën për t'u përjashtuar nga shqyrtimi i rastit dhe anëtarët e tjerë të kolegjit besojnë se ky vendim është i padrejtë. Gjyqtarët bëtohen me rastin e marrjes së detyrës se do të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të paanshme. Ekziston edhe obligimi profesional ose etik për të vendosur në mënyrë të paanshme në të gjitha çështjet. Prandaj, një gjyqtar mund të p në mënyrë të përjashtoj veten sa herë që mund të lindë rreziku i anshmërisë (ose shqetësim për anshmëri).

Integriteti gjyqësor është i një rëndësie të madhe: një proces gjyqësor i drejtë dhe i paanshëm është parakusht për qeverisje të përgjegjshme dhe masë mbrojtëse kundër korrupsionit. Integriteti në sistemin e drejtësisë shërben si parandalues i veprime të jashtëligjshme dhe si katalizator i sundimit të ligjit: gjyqësori i paanshëm siguron jo vetëm parandalimin e korrupsionit brenda sistemit të drejtësisë, por edhe lufton atë në të gjitha nivelet e shoqërisë. KDI fuqimisht beson se përmirësimi i integritetit të gjyqësorit është mënyra më efektive për të kthyer besimin e publikut dhe për të luftuar korrupsionin.



SHTOJCA 2: SISTEMI I DREJTËSISË NË KOSOVË

GJYKATAT E KOSOVËS

Që nga 1 janari i vitit 2013, është prezantuar një sistem i strukturuar i drejtësisë në Kosovë me shtatë (7) gjykatat themelore⁴⁵ si gjykata të shkallës së parë, Gjykatën e Apelit (me kompetencë për të shqyrtuar dhe vendosur ankesat nga vendimet e gjykatave themelore) dhe Gjykata Supreme si autoriteti më i lartë gjyqësor në Kosovë. Në secilën gjykatë themelore, kryetari i Gjykatës është përgjegjës për menaxhimin dhe veprimet e Gjykatës, ndërsa në secilën degë, një gjyqtarë mbikëqyrës është përgjegjës para kryetarit të Gjykatës për veprimet e asaj dege⁴⁶. Të gjithë gjyqtarët emërohen dhe shkarkohen nga Presidenti i Kosovës me propozim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK)⁴⁷. Përveç rekrutimit dhe propozimit të kandidatëve për emërim në detyrën gjyqësore, KGJK-ja është gjithashtu përgjegjëse për një varg detyrash mbikëqyrëse dhe administrative.⁴⁸

PROKURORI SHETËTOR

Në Kosovë, roli i prokurorit të shtetit është që të inicioj hetimet penale, të zbulojë dhe të mbledhë dëshmi dhe informata, dhe në fund të ngrëjë aktakuza dhe të

ndjekë penalisht personat e dyshuar për vepra penale. Përbëhet nga Prokuroria Themelore, Prokuroria Speciale, Prokuroria e Apelit dhe Zyra e Prokurorit të Shtetit. Prokuroria Themelore përbëhet nga Departamenti i Përgjithshëm dhe Departamenti për Krime të Vogla dhe të Rënda. Çdo rast që përfshin çështjet komerciale dhe administrative duhet të caktohet brenda Departamentit të Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore. Prokuroritë themelore ekzistojnë në shtatë komunat më të mëdha: Prishtinë, Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë dhe Prizren. Prokurorët emërohen, riemërohen dhe shkarkohen nga Presidenti i Kosovës me propozim të Këshillit Prokurorial të Kosovës⁴⁹. KPK-ja propozon kandidatët në bazë të meritës dhe në mënyrë transparente, duke marrë parasysh barazinë gjinore dhe përbërjen etnike.

ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS

Oda e Avokatëve të Kosovës (OAK) është një organizatë vetëqeverisëse e avokatëve kosovarë që funksionon në mënyrë të pavarur nga institucionet shtetërore. Kuvendi i Kosovës themeloi Odën e Avokatëve të Kosovës (më tutje "OAK") pas miratimit të Ligjit mbi Avokaturën dhe ndihmë tjetër juridike, Gazeta Zyrtare e KSAK-së, nr. 011-69 / 79. Aktualisht, korniza ligjore për

45 7 Gjykatat Themelore në Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjilan dhe Ferizaj kanë secila disa "Degë të Gjykatave". Njëzet (20) Degët e Gjykatave janë në komunat më të vogla.

46 Integriteti Gjyqësor në Kosovë, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (2014).

47 Në bazë të Kushtetutës, mandati i anëtarëve të Këshillit është pesë (5) vjet dhe Këshilli përbëhet nga 13 anëtarë, tetë prej tyre zgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ndërsa pesë (5) anëtarë zgjidhen nga gjyqtarët. Sekretariati ndihmon Këshillin në zbatimin e rregullave dhe politikave të saja në lidhje me menaxhimin, buxhetin dhe administratën e gjykatave. Brenda Këshillit, funksionojnë Njësia e Shqyrtimit të Performancës Gjyqësore (NSH-PGJ) dhe Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZDP).

48 KGJK-ja transferon gjyqtarët sipas nevojës, zhvillon dhe rregullon procedurat disiplinore gjyqësore, bën administrimin gjyqësor dhe mbikëqyr funksionin e auditimit gjyqësor të gjykatave, zhvillon rregullat gjyqësore, punëson dhe mbikëqyrë administratorët e gjykatave, zhvillon dhe mbikëqyrë buxhetin gjyqësor, përcakton numrin e gjyqtarëve në çdo juridiksion dhe i rekomandon kuvendit krijimin e gjykatave të reja.

49 KPK është një institucion i pavarur përgjegjës për "rekrutimin, propozimin, promovimin, trajnimin, transferimin, riemërimin dhe disiplinimin e prokurorëve". Përbërja e saj u zgjerua dhe u reformua sipas ndryshimeve të bëra në ligj në qershor të vitit 2015. Këshilli ka 13 anëtarë dhe është shumë më tepër përfaqësues. Prej tyre, 10 anëtarë janë emëruar nga secila prokurori, duke përfshirë një nga Prokuroria e Shtetit, shtatë nga Prokuroritë Themelore, një nga Prokuroria Themelore e Apelit dhe një nga Prokuroria Speciale.

Tre anëtarët e mbetur vijnë nga sektorë të tjerë. Ato përfshijnë një avokat të emëruar nga Oda e Avokatëve, një profesor nga Fakulteti Juridik dhe një përfaqësues i shoqërisë civile. Ministri i drejtësisë nuk është më anëtar i KPK-së, sikurse deri në qershor të vitit 2015. Tre anëtarët jo-prokurorë duhet të zgjidhen nga shumica në Kuvend. Në ligjin e ndryshuar, kërkesa e re për përfaqësuesin e shoqërisë civile është se ai / ajo duhet të ketë përvojë pune juridike për më shumë se pesë vjet, të mos ketë qenë anëtare ose i përfshirë në ndonjë aktiviteti politik në tre vitet e fundit dhe të ketë mbështetjen e më shumë sesa pesë OSHC.



veprimtarinë e OAK-ut përbëhet nga Ligji për Avokaturën Nr. 03 / L-117 të datës 12 shkurt 2009, që shfuqizon Ligjin për Avokatinë dhe Ndihmën tjetër Juridike. Statuti i OAK është një akt normativ i nivelit më të lartë, siguron një organizim të plotë të brendshëm të Odës. OAK është i vetmi autoritet për licencim të avokatëve në Kosovë si pjesë integrale e sistemit të drejtësisë. Oda synon avancimin e sundimit të ligjit duke mbështetur procesin e reformave ligjore. OAK duhet të shërbejë si garanci e standardeve të larta të profesionalizmit, kompetencës, besimit dhe sjelljes etike

POLICIA E KOSOVËS

Forca e policisë së Kosovës është institucion për zbatimin e ligjit, përgjegjëse për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike në të gjithë vendin. Policia e Kosovës është institucion që synon ofrimin profesional, efektiv dhe efikas të zbatimit të ligjit në Kosovë përmes mbrojtjes së jetës dhe pronës, ruajtjes së ligjit dhe rendit publik, parandalimit dhe zbulimit të krimit, mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut dhe trajtimit të barabartë të të gjithë qytetarëve pa marrë parasysh racën, ngjyrën, fenë, gjininë ose moshën e tyre. Policia e Kosovës është e organizuar në pesë (5) departamente:

1. Departamenti i Operatives
2. Departamenti i Hetimeve
3. Departamenti i Policisë Kufitare
4. Departamenti i Shërbimit Mbështetës
5. Departamenti i Burimeve Njerëzore

Departamenti i Hetimeve përbëhet nga njësitë e mëposhtme:

- Divizioni për Hetimin e Krimit
- Divizioni Kundër Krimit të Organizuar dhe
- Njësia Speciale e Antikorrupsionit / Task Forca Antikorrupsion

Departamenti Special Antikorrupsionit (DSAK) ose i ashtuquajtur 'Task Forca Anti-Korrupsion' vepron si një njësi e specializuar brenda Departamentit të Hetimeve dhe ka për qëllim parandalimin, hetimin dhe zbulimin e veprave penale kundër ekonomisë, financave dhe korrupsionit. Misioni i DSAK-së është hetimi dhe luftimi i veprave penale të korrupsionit të nivelit të lartë në Republikën e Kosovës. Së bashku me Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, Departamenti kryen hetime të kryerësve të veprave penale, dokumentimin e veprimtarisë kriminale dhe sjelljen e të dyshuarve para organeve të drejtësisë.



SHTOJCA 3: MEKANIZMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Ky seksion jep një përshkrim të shkurtër të mekanizmave të kontrollit të brendshëm përgjegjës për hetimin e aktorëve të sistemit të drejtësisë kur raportohet dyshimi për sjellje të papranueshme ose të pahijshme. Autori është plotësisht i vetëdijshëm se këto mekanizma nuk janë përgjegjëse për luftimin e korrupsionit tek aktorët e sistemit të drejtësisë, por shpeshherë akuzat për sjellje të pahijshme mund të çojnë në akuza serioze për korrupsion. Informatat e dhëna në këtë seksion do të kontribuojë në një pasqyrë gjithëpërfshirëse të sistemit të drejtësisë në Kosovë.

KOMISIONI DISIPLINOR I KGJK-SË

KGJK ushtron kontroll disiplinor mbi gjyqtarët përmes Komisionit të tij të Përhershëm Disiplinor i cili, nga ana tjetër, mbështetet në Zyrën e Prokurorit Disiplinor (ZPD). Në rastet kur konstatohet se ka ndodhur sjellja e pahijshme, Komisioni Disiplinor mund të vendosë sanksione që përfshijnë paralajmërimin, gjobën, transferimin ose suspendimin e gjyqtarit dhe, në raste veçanërisht serioze, largimin e gjyqtarit nga pozita e tyre.

Komisioni Disiplinor i KGJK-së (KD-KGJK) përbëhet nga tre anëtarë të emëruar nga KGJK-ja. Komisioni merr vendimin përfundimtar nëse do të vendos sanksione në përputhje me rregullat dhe procedurat e vendosura në procedurat disiplinore. Masat e tilla përfshijnë vërejtje qortuese, zvogëlim të përkohshëm të pagave dhe propozim për largimin e gjyqtarit / prokurorit. Ankesat kundër vendimit të komisionit mund të dorëzohen në KGJK brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit të prerë.

KOMISIONI DISIPLINOR I KPK-SË

Komisioni Disiplinor i KPK-së (KD-KPK) përbëhet nga tre anëtarë të emëruar nga KPK-ja. Komisioni merr vendimin e prerë nëse do të vendosë sanksione në përputhje me rregullat dhe procedurat e vendosura në procedurat disiplinore. Masat e tilla përfshijnë vërejtje qortuese, zvogëlim të përkohshëm të pagave dhe propozim për largimin e prokurorit. Ankesat kundër vendimit të komisionit mund të dorëzohen në KPK brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit të prerë.

ZYRA E PROKURORIT DISIPLINOR

Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZKD) është një institucion i veçantë dhe i pavarur i zgjedhur nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), përgjegjëse për hetimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve kur ka një ankesë të arsyeshme ose dyshim për sjellje të pahijshme. Sjellja e pahijshme përcaktohet si:

- (1) dënim për vepër penale;
- (2) pakujdesi në kryerjen, mos-kryerjen ose keqpërdorimin e funksioneve gjyqësore;
- (3) moszbatimi i funksioneve gjyqësore në mënyrë të pavarur dhe të paanshme;
- (4) shkelje e kodit të etikës në fuqi.

Kjo zyre ka të drejtë të hetojë të gjitha çështjet dhe nga provat e marra të vendosë nëse do të paraqesë masa disiplinore në Komisionin Disiplinor të KGJK-së dhe të KPK-së. Zyra i raporton KGJK-së dhe KPK-së në baza vjetore për aktivitetet dhe shpenzimet e saj.

Zyra e Prokurorit Disiplinor, në Raportin Vjetor 2016, numëroi një sërë sfidash. Disa prej tyre janë të ndërlidhura me paaftësinë e ZPD-së për të administruar në mënyrë të pavarur buxhetin e saj që reflektohet në përpjekjet për rekrutimin e personelit shtesë. ZPD-ja vazhdon të përballlet me kapacitete të pamjaftueshme profesionale dhe administrative për të përmbushur detyrat e saj ligjore në kryerjen e hetimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Zyra ja më tutje nënvizon se Ministria e Financave asnjëherë nuk i ka marrë këto vërejtje me seriozitet.

ZPD-ja është e varur si nga Këshilli Gjyqësor ashtu dhe ai Prokurorial. Të dy këshillat janë autoriteti përfundimtar mbi atë se për çka dhe ndaj kujt duhet të zbatohen masat disiplinore.⁵⁰ Në Raportin Vjetor 2016, ZPD raporton "pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë (556) ankesa të paraqitura nga qytetarët, institucionet, personat juridik që në krahasim me vitin e kaluar ka një rritje të lehtë prej 7 përqind.⁵¹ Gjatë të njëjtës periudhë të raportimit, 643 raste janë refuzuar pas hetimeve paraprake (një numër i këtyre ankesave janë dorëzuar në ZPD gjatë vitit 2015); 78 raste i janë bashkëngjitur rasteve tjera dhe 142 janë bartur në vitin 2017. Sipas ZPD-së, shumica e ankesave refuzohen për shkak të mungesës së fakteve dhe rrethanave të bazuara mirë që e pamundësojnë atë të fillojë hetimin disiplinor.⁵²

Gjatë vitit 2016, ZPD-ja ka dorëzuar dymbëdhjetë (12) raporte përfundimtare pranë Komisionit Disiplinor të KGJK-së dhe tetë (8) raporte në Komisionin Disiplinor të KPK-së. Komisioni Disiplinor i KGJK-së shqyrtoi dhe vendosi për 18 raste disiplinore kundër gjyqtarëve (disa raste të shqyrtuara ishin dorëzuar gjatë vitit 2015). Ngjashëm, Komisioni Disiplinor i KPK-së shqyrtoi dhe vendosi 19 lëndë disiplinore kundër prokurorëve. Komisioni Disiplinor i KGJK-së i dha vërejtje qortuese një gjyqtari, gjashtë (6) gjyqtarë u liruan dhe një gjyqtar mori pezullim të përkohshëm, ndërsa Komisioni Disiplinor i KPK-së dha 6 vërejtje, 2 prokurorë u pezulluan përkohësisht, 3 prokurorë u liruan dhe një prokuror mori ulje të përkohshme të pagës

50 Një pjesëmarrës në Fokus Grupi i IIGJ, Prishtinë, 28 qershor, 2017

51 Zyra e Prokurorit Disiplinor (2017), Raporti Vjetor i Punës 2016, faqe 6

52 Po aty, faqe 7

ZYRA DISIPLINORE NË ODËN E AVOKATËVE TË KOSOVËS

Ekziston edhe një sistem disiplinor i përfshirë në statutin e OAK-së. Sistemi përbëhet nga Komisioni Hetues Disiplinor, Komisioni i Shqyrtimit Disiplinor dhe Komisioni i Ankesave, anëtarët e të cilit emërohen nga Asambleja e OAK-së me propozimin e Bordit Drejtues të OAK-së.

Mandati i zyrës disiplinore zgjat tre vjet me mundësi riemërimi. Sistemi i ri zgjeron numrin e subjekteve që mund të inicojnë një procedurë disiplinore ndaj një avokati, duke vendosur gjithashtu garancinë e kërkuar për procedurë disiplinore të drejta, të paanshme dhe efektive.

INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS

Inspektorati Policor është një institucion i pavarur përgjegjës për hetimin e shkeljeve disiplinore të profilit të lartë. Rastet disiplinore të profilit të lartë përfshijnë: konfliktet mes policisë dhe komunitetit; përdorimi i forcës vdekjeprurëse; vdekjet gjatë arrestit policor dhe aksidentet fatale të trafikut që përfshijnë personelin e policisë. Inspektorati është gjithashtu përgjegjës për parandalimin, hetimin dhe dokumentimin e çdo veprimtarie kriminale të kryer nga pjesëtarët e policisë për të cilat nuk kanë të drejtë imuniteti.

Agjencia kombinon dy funksionet kryesore në ndjekje të parimeve të përgjegjësisë dhe transparencës - shtyllat e policisë demokratike:

- Parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe hetimin e veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë, pa marrë parasysh pozicionin dhe gjininë gjatë ushtrimit të detyrës ose jashtë detyrës, duke përfshirë edhe incidentet disiplinore të profilit të lartë dhe hetimin disiplinor të zyrtareve policor me rang më të lartë dhe të nivelit më të lartë drejtues dhe zyrtarë të nivelit të lartë ekzekutiv.
- Inspektimin e strukturave dhe funksioneve të Policisë së Kosovës (PK) për të siguruar llogaridhënien, efikasitetin dhe efektivitetin e zbatimit të ligjit, ligjit statutor dhe procedurave standarde të operimit.

